

2013



Dr. sc IMËRLIJE ALILI

METODOLOGJIA E PUNËS HULUMTUESE SHKENCORE

Konceptet themelore të metodologjisë:

- Metodologjia (koncepti)
- Shkenca (Struktura e njohurisë shkencore)
- Nocioni i metodës shkencore
- Parimet e njohurive shkencore
- Procedura metodologjike (fazat kryesore të procesit të hulumtimit - shkurtimisht)
- Llojet e hulumtimit (kriteret themelore për dallimin midis llojeve të hulumtimit)
- Fusha dhe të dhënat e hulumtimit në shkencat shoqërore
- Treguesit

Metodologjia (nocioni dhe qëllimi)

Metodologjia (rrjedh nga fjalët greke *methodos* - rrugë dhe *logos* – dije, shkencë) është studimi i metodave dhe mënyrave të fitimit të njohurive shkencore (materiale, sociale dhe shpirtërore). Metodologjia është shkencë për shkencën. Ajo është meta-shkencë apo mendimi për të menduarit. Qëllimi i metodologjisë është që të kuptohet thelbi i njohurive shkencore dhe të vendosë parimet themelore në përvetësimin e saj dhe shqyrtimin kritik. Përveç kësaj, metodologjia na mëson se me cilat mjete duhet të shërbehemi që të arrijmë të njohim në mënyrë më të vërtetë (objektive) botën.

Shkenca (strukturë e njohurive shkencore)

Shkenca është një sistem i njohurive të realitetit të përcaktuar në mënyrë objektive dhe që i shërben njeriut për të përmirësuar jetën e tij dhe për të studiuar atë realitet.

Struktura e njohurive shkencore

Ekzistojnë nivele të ndryshme të dijes shkencore, duke filluar nga të dhënat dhe faktet, përmes ligjeve dhe teorive deri në tërë sistemet shkencore.

Të dhënat. Çdo punë hulumtuese-shkencore empirike fillon me mbledhjen e të dhënave. Të dhëna shkencore relevante janë ato të dhëna që janë në funksion të hulumtimit, ose, të cilat janë të specifikuar në qëllimin e hulumtimit dhe që mund të lidhen me hipotezën e parashtruar. Pastaj, këto janë të dhëna të mbledhura me teknika dhe procedura të standardizuara për mbledhjen e të dhënave.

Faktet (dëshmitë). Paraqesin marrëdhënie empirike të themeluara në mënyrë artificiale në natyrë dhe në shoqëri, p. sh. fakt është "*që në dimër bie borë*". Faktet janë publike, të verifikuara dhe të testueshme dhe përfaqësojnë shtyllën e parë mbi bazën e të cilave mund të pretendojmë diçka në shkencë.

Ligjet janë pak a shumë një pasqyrim subjektiv i saktë i ligjshmërive ekzistuese reale. Ligjshmëria paraqet një marrëdhënie të caktuar në mes sendeve dhe fenomeneve natyrore dhe shoqërore, të cilat ekzistojnë pavarësisht nga njohuritë tona. Karakteristikat kryesore të ligjeve shkencore janë:

- 1) Ligji gjithmonë shpreh një marrëdhënie, për shembull lidhjen në mes dukurive të caktuara në natyrë dhe në shoqëri;
- 2) Ligjet empirike shkencore paraqesin marrëdhënie të përgjithshme, universale dhe të vazhdueshme.

Ligji shkencor ideal ka vlerë universale dhe prandaj vlen për të gjitha rastet e referuara; Për dallim nga ligjet në shkencat natyrore ku A i paraprin B, ligjet në shkencat shoqërore nuk kanë vlerë të tillë të përgjithshme dhe universale. Në shkencat shoqërore, A i paraprin B nëse

plotësohen kushtet a, b, c... Për këtë arsye, që në këto kushte ligji të ketë status të ligjit shkencor është e nevojshme që saktësisht të përcaktohen të gjitha kushtet relevante, d.m.th. të paraqitet se nën çfarë kushtesh dukuria (fenomeni) A është e lidhur me dukurinë B.

Llojet më të zakonshme të ligjeve në shkencat shoqërore janë:

- **ligjet e temporale** (te ligjet temporale koha paraqitet si përcaktues i rëndësishëm i ligjit, për shembull, *me kalimin e kohës procesi i të harruarit është më i ngadalshëm*);
- **ligjet funksionale** (tregojnë lidhjen e fenomeneve të caktuara që nuk janë në marrëdhënie shkakësore, por të dyja janë funksion i një faktori të tretë);
- **ligjet kauzale** (kanë të bëjnë me shpjegimin e lidhjeve shkakësore midis dukurive të caktuara)

Teoritë janë shpjegime gjithëpërfshirëse të fenomeneve të caktuara ose të grupeve të dukurive. Edhe pse janë të bazuara në ndërtimin empirik (bashkojnë një numër të ligjeve dhe përpiqen t'i lidhin dhe t'i shpjegojnë), gjegjësisht, teoritë kryesisht janë hipotetike. Veçanërisht, kjo është karakteristikë për shkencat shoqërore, ku çdo teori përbëhet prej shumë elementeve të aspektit hipotetik (boshllëqet mbushen me supozime, p.sh. për ekzistimin e një fenomeni, ose lidhjen e një fenomeni, ose me nxitjen e një fenomeni).

Sistemet shkencore janë shpjegime të plota, gjithëpërfshirëse, multidisiplinare të fenomeneve natyrore ose shoqërore që në vete integrojnë faktet, ligjet dhe teoritë.

Koncepti i metodës shkencore

Metoda paraqet mënyrë të menduarit dhe hulumtimit në shkencë. Metoda shkencore përdoret për të fituar njohuri sa më reale. Metoda në kuptimin e gjerë përfshin tre komponentë themelor:

- qasjen e përgjithshme hulumtuese (Parimet e njohurive shkencore)
- procedurat metodologjike hulumtuese (fazat e procedurës hulumtuese)
- metodat dhe teknikat e hulumtimit.

Qasja e përgjithshme (njohuri paraprake), është njohuria për parimet e përgjithshme për dijen shkencore (objektiviteti, besueshmëria, saktësia, etj.). Në komponentin e dytë, bëhet fjalë për njohuritë në lidhje me procedurat dhe proceset e dijes të njohurive shkencore (fazat e hulumtimit shkencor). Komponentin e tretë të metodës e përbën njohuria për teknikat e hulumtimit dhe mbledhjes të të dhënave

Aplikimi i metodës të njohurive shkencore garanton objektivitet - që konkluzionet e fituara me hulumtimin të jenë të vërteta.

Parimet e njohurive shkencore

Ekzistojnë disa parime që karakterizojnë shkencën, për shembull, krahasuar me dijen racionale. Disa nga parimet më të rëndësishme janë:

- parimi i objektivitetit,
- parimi i besueshmërisë,
- parimi i universalitetit,
- parimi sistematizimit
- sinteza e induksionit dhe deduksionit,
- sinteza sasiore (kuantitative) dhe cilësore (kualitative).

Parimi i objektivitetit të njohurisë shkencore

Parimi i objektivitetit ka disa rëndësi themelore. E para, dhe më kryesorja është njohja dhe përdorimi i *logjikës* apo mënyrës shkencore të dijes (aplikimi i procedurës metodologjike). Në kuptimin e dytë objektivitetit nënkupton *paanësinë* ndaj të dhënave dhe fakteve deri te të cilat studiues vjen. Shkencëtari informacioneve dhe fakteve u qaset me “duar sterile” pa paragjykime personale, kulturore, ideologjike dhe paragjykime të tjera. Më në fund, objektiviteti përmbushet nëse ekziston miratim *ndër subjektiv*, nëse ajo deri te e cila kemi arritur është e verifikueshme (nëse studiues të tjerë duke përdorur të njëjtën metodologji do të arrijnë rezultate të njëjta).

Parimi i besueshmërisë së njohurive shkencore

Besueshmëria është e kënaqur në qoftë se rezultatet e fituara në hulumtim janë relativisht të përhershme, nëse në hulumtimin e përsëritur arrihen rezultate të njëjta, nëse në periudhë relativisht të gjatë kohore rezultatet (gjetjet) themelore kërkimore përballojnë kritikën, nëse karakteristikat themelore të fenomenit mbeten të pandryshuara (të qëndrueshme, stabile).

Parimi i saktësisë së njohurive shkencore

Parimi i saktësisë më mirë kuptohet në aplikimin e gjuhës. Gjuha e shkencës është e saktë deri në atë masë sa që çështja e kuptimit të nocioneve themelore nuk duhet të vijë në pyetje. Në punën shkencore përdoren ato simbole që kanë të përcaktuara të gjitha dimensionet themelore, ndërsa një simbol mund të ketë vetëm një kuptim.

Parimi i përgjithësisë (universalitetit) të njohurive shkencore

Parimi i përgjithësisë. Shkenca synon të zbulojë atë që është e përgjithshme, që vlen për një numër të rasteve individuale të caktuara. Përderisa te shkencat natyrore parimi i përgjithësisë kryesisht është i përmbushur, në shkencat shoqërore përgjithësia është e kushtëzuar. Ligjet shoqërore janë të vlefshme nën kushte të caktuara. Që një ligj në shkencat shoqërore të plotësojë kërkesat e vlerës shkencore, përveç vetë ligjit duhet të përcaktojë edhe kushtet nën të cilat ai ligj ushtrohet.

Parimi sistematik i njohurive shkencore

Parimi i sistematizimit. Shkenca paraqet një sistem të plotë të njohurive që mund të jenë të lidhura në aspekt funksional ose të kauzalitetit (lidhja shkak - pasojë). Çdo fakt, ligj, teori, etj. Deri te të cilat studiuesi arrin në hulumtim duhet të vendoset në lidhje me të gjitha njohuritë shkencore.

Sinteza e induksionit dhe deduksionit

Sinteza e induksionit dhe deduksionit. Deduksioni, karakteristikë e rrugës së njohurisë shkencore për analizë racionale teorike. Pikënisjen e ka në një qëndrim përgjithësisht të pranuar dhe përfundon në raste individuale dhe të veçanta ("prej lartë – poshtë"). Induksioni, paraqet rrugën e kundërt të dijes ("prej poshtë - lartë") dhe është karakteristikë e hulumtimit empirik. Fillohet prej të dhënave të mbledhura (individuale) dhe sillet konkluzion i përgjithshëm, i cili pastaj vlen për të gjitha rastet.

Shembull: Si është dashur të mendohet në Mesjetë?

Edhe pse mundësitë e vëzhgimit dhe konkludimit induktiv i kanë qenë gjithmonë në dispozicion njeriut, gjatë shumë viteve ka ndodhur që ai nuk ka besuar në atë që ka pa, dëgjuar, që ka mund të nuhas, shijoj ose prekë. Besimi në Zot ka qenë mbi besimin në vete. Në një prej shënimeve të tij, Francis Bacon (1605) jep shembull të një diskutimi skolastik (shkollor) për fenomenin natyror.

"Viti 1432 p.e.r. Është zhvilluar debat i nxehtë ndërmjet vëllezërve murgj mbi numrin e dhëmbëve në gojën e kalit. Debat i zgjatur plot 13 ditë. Janë nxjerrë dhe shfrytëzuar të gjithë librat e vjetra dhe kronikat dhe kjo siguroi një erudicion (mësim) kaq të madh dhe të thellë si kurrë më parë në këtë fushë. Në fillim të ditës së katërmëdhjetë, një murg i ri me prejardhje nga një familje me reputacion i pyeti udhëheqësit e tij të ditur që edhe ai të thotë një fjalë, dhe për çudi të diskutantëve, mençuria e thellë e të cilëve ishte shqetësuar shumë - ai u lut atyre që gjërat t'i zgjedhin në mënyrë vulgare dhe të paparë: gjegjësisht, të hapin gojën e një kali, të numërojnë dhëmbët dhe të gjejnë zgjidhjen e problemit të tyre. Diskutuesit e tjerë, duke u ndjerë thellë të lënduar për dinjitetin e tyre, me shumë zhurmë dhe duke bërë titur e detyruan që të dalë jashtë. Sepse, thanë ata, është e sigurt që edhe vetë Satana (dreqi) ka hyrë në të dhe është çmendur, pasi që ka përmendur rrugën e egër dhe të prishur për zbulimin e së vërtetës, e cila është në kundërshtim me mësimin e gjithë Etërve të Kishës. Pas edhe më shumë ditëve me zënka dhe diskutime, pëllumbi i paqes zbriti në grupin tonë dhe të gjithë si deklaruan që problemi do të mbetet një mister i përjetshëm për mungesë të trishtuar të të dhënave historike dhe teologjike për atë, dhe urdhëruan që kjo të shënohet."

Mënyra moderne e njohurive shkencore përfshin sintezën e induksionit dhe deduksionit. Në hulumtimet moderne niset prej qëndrimit të përgjithshëm të hipotezës, e cila testohet (pranohet ose refuzohet) bazuar në të dhënat e mbledhura empirike.

Sinteza sasiore dhe cilësore

Sinteza e sasiore dhe cilësore. Në periudha të ndryshme të zhvillimit të metodës shkencore, kanë dominuar analiza cilësore ose sasiore. Për shembull, rruga e njohurive e Aristotelit “konsistenca deduktive” nënkuptonte kryesisht analizën kualitative (cilësore) logjike. Nga ana tjetër, pozitivistët kanë tendencë krijimin e marrëdhënie sasiore që më pas nuk duhej interpretuar. Mënyra moderne e njohurive shkencore përfshin sintezën sasiore dhe cilësore në analizë. Analiza kuantitative nënkupton matjen (konstatimin e marrëdhënieve, lidhjes), dhe interpretim cilësor të këtyre marrëdhënieve (lidhjeve, raporteve).

Procedura metodologjike (fazat kryesore të procesit të hulumtimit)

Procedura metodologjike përbëhet nga disa faza të caktuara, veprime nëpërmjet të cilave kërkimi kalon dhe paraqesin një garanci të caktuar të objektivitetit (njohuri e vërtetë shkencore). Fazat e procedurave kërkimore në mënyra të ndryshme janë të përcaktuara në literaturë. Megjithatë, në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me disa veprime themelore:

- formulimi i problemit hulumtues (kërkimor)
- definimi teorik dhe operativ (punues) i dukurisë që është subjekt i hulumtimit
- vendosja e supozimeve të mëparshme – hipotezat e kërkimit
- mbledhja e të dhënave
- shpjegim shkencor dhe verifikimi i hipotezave

Faza e parë e hulumtimit paraqet identifikimi e *lëndës kërkimore* ose *problemit kërkimor* (*hulumtues*). Lënda e hulumtimit zakonisht është një marrëdhënie (lidhje) e caktuar në mes dukurive (fenomeneve), prandaj përcaktimi i lëndës përfshin së pari, përcaktimin e vetë fenomeneve ndërmjet të cilave lidhja është përcaktuar, dhe pastaj përcaktimin e natyrës së vetë marrëdhënies.

Përkufizimi teorik i problemit kërkimor paraqet operacion logjik me të cilin përmes koncepteve abstrakte përcaktohet thelbi i fenomenit që hulumtohet. Definimi operacional (punues) i problemit qëndron në përcaktimin e treguesve (indikatoreve, koeficienteve) që mund të ekzaminohen dhe testohen në mënyrë empirike dhe të cilët përfaqësojnë manifestim të konceptit të jashtëm abstrakt. Për shembull, përkufizimi i “lumturisë” mund të jenë pohimet e njerëzve nëse janë të lumtur apo jo.

Pasi të realizohet definimi i operativ, parashtrohen hipotezat (supozimet) kërkimore. Funkcioni i tyre është që të supozohet lidhja midis dukurive që i hulumtojmë dhe faktorëve të tjerë të cilët

sipas supozimit mund të jenë në ndonjë farë lloj lidhjeje (p.sh. të shkakësisë). Qëllimi i hulumtimit është që të verifikohet realizueshmëria e hipotezës së parashtruar.

Në fazën e ardhshme të hulumtimit mblidhen dhe klasifikohen (përpunohen) të dhënat. Këtu, veç më hyhet në fazën kritike të hulumtimit shkencor - faza e shpjegimit shkencor dhe përcaktimit të lidhjeve, p.sh. korrelacionit (për shkallën e lidhjes midis dy ose më shumë dukurive) ose marrëdhënieve funksionale (ligjet funksionale më shpesh thjesht përcaktojnë lidhjen reciproke të fenomeneve - kur ndryshon njëra dukuri, ndryshon edhe tjetra), ose marrëdhëniet shkakore (kur njëra dukuri, variabël i pavarur, kusht i mjaftueshëm, është shkak i ndryshimeve të dukurisë tjetër, variabël i varur).

Llojet e hulumtimit (kriteret themelore për klasifikimin e llojeve të hulumtimit)

Ekzistojnë kriteret të ndryshme për të bërë dallimin midis llojeve të hulumtimit.

- I pari, është i bazuar në dallimin midis llojeve të kërkimit sipas qëllimit të tyre përfundimtar (sipas këtij kriteri dallojmë hulumtime eksploruese, shpjegues, përshkruese dhe parashikuese);
- Kriteri i dytë bazohet në faktin se a bëhet fjalë për një studim të vetëm ose për një seri të studimeve të ndërlidhura (hulumtimet e vetme dhe të zhvillimit);
- Kriteri i tretë ka të bëjë me përcaktimin ndërmjet hulumtimeve jo-eksperimentale (të sondazhit, anketimit) dhe hulumtimeve eksperimentale.

Dallimi i llojeve të hulumtimit në bazë të qëllimit

- a) Qëllimi i hulumtimit mund të jetë – **një zbulimi** (eksplorim) i dukurisë (fenomenit).

Qëllimi i hulumtimit mund të jetë një studim apo eksplorim, kërkim i ri, e dukurisë më shumë ose më pak e panjohur dhe rrethanat në të cilat ajo paraqitet. Hulumtimi eksplorues (zbulues) kërkimor është i fokusuar në identifikimin e fenomeneve, ndarjen e tyre reciproke, identifikimi i tipareve karakteristike të tyre, shpeshhtësinë e ndodhjes (frekuencat e paraqitjes) etj. (me një fjalë, njohjen e dukurisë).

- b) Qëllimi i hulumtimit mund të jetë – **një përshkrim** (deskripcion) i dukurisë

Objektivi i dytë mund të jetë përshkrimi ekzakt ose deskripcioni i fenomenit. Qëllimi i tillë vendoset kur bëhet fjalë për fenomen të rëndësishëm që duhet të njihet saktë dhe të përshkruhet maksimalisht në mënyrë objektive, të definohet ose ri definohet.

c) Qëllimi i hulumtimit mund të jetë - **një shpjegim** (shtjellim) i dukurisë

Objektivi i tretë mund të jetë një shpjegim apo shtjellim i një fenomeni. Hulumtimet shpjeguese merren me dukuritë të cilat kanë qenë të përshkruara më parë, dhe tani ne duam që ata t'i shpjegojmë. Te hulumtimet shpjeguese fillohet nga një apo më shumë supozime rreth lidhjes midis fenomenit dhe ndonjë dukurie tjetër. Hulumtimi duhet të pohoj apo mohojë supozimet e tilla të parashtruara.

d) Qëllimi i hulumtimit mund të jetë – **një parashikim** i dukurisë

Së katërti, hulumtimi mund të organizohet me qëllim që të sigurojë një parashikim të dukurisë në kuptimin e paraqitjes së fenomeneve të caktuara, ndryshimeve në karakteristikat e tyre thelbësore. Hulumtimet parashikuese janë vetëm një lloj i veçantë i hulumtimit eksplorues.

Hulumtimet e një hershme ose kërkimet zhvillimore

Hulumtuesi zakonisht planifikon kërkime vetëm të një hershme, por nuk janë të rralla rastet që hulumtimet të realizohen në seri (hulumtimet zhvillimore) duke filluar nga eksplorimi (njohja e dukurisë), përshkrimi i saj (përshkrimi i saktë dhe përkufizimi), deri në shpjegimin dhe parashikimin (parashikimi i fenomeneve të tjera të bazuara në të).

Hulumtimet eksperimentale dhe jo-eksperimentale

Në hartimin e studimeve eksperimentale çështja kryesore lidhet me manipulimin eksperimental të faktorit eksperimental dhe kontrollit të variablave të tjera. Te hulumtimet jo-eksperimentale çështjet kryesore kanë të bëjnë me zgjedhjen e një mostre përfaqësuese, përdorimi i procedurave standarde për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave.

Lënda (subjekti) dhe të dhënat në hulumtimin dukurive shoqërore

Nocioni i lëndës: Lëndë është cilido element i realitetit, real apo imagjinar që është me interes për ne ose shkencën. Çfarë mund të jetë subjekt i hulumtimit në shkencat shoqërore. Në përgjithësi lëndë e studimeve mund të jenë dukuritë shoqërore, ngjarjet shoqërore ose proceset shoqërore.

Dukuria shoqërore është gjithçka që po ndodh ose ekziston në një hapësirë të veçantë fizike ose sociale dhe në një kohë të dhënë. Në fenomene shoqërore mund të përfshijmë çdo gjë që ndodh në marrëdhëniet midis njerëzve dhe komuniteteve të tyre. Fenomenet sociale janë, për shembull jeta lagjet me varfëri, sistemi politik ose sistemi i vlerave në bashkësi dhe kështu me radhë.

Ngjarja paraqet një grup të tërë të ngjarjeve që ka fillimin e tij, progresin dhe përfundimin, respektivisht rezultatin e tij. Në aspekt kohor është i kufizuar dhe shpesh është afatshkurtër. Ngjarje është një lojë futboll, tubim politik, ditë e Camellias, etj.

Procesi paraqet një grup kompleks të ngjarjeve që kanë një drejtim të përbashkët të zhvillimit. Proceset janë të zakonshme afatgjatë dhe kohëzgjatja e tyre matet me vite apo dekada, për shembull, urbanizimi ose pranimi i internetit si një medium ose globalizimi. Procese nuk janë aq të thjeshtë si ngjarja dhe në vetvete mund bashkon një mori të dukurive dhe ngjarjeve shoqërore.

Indikatorët (Treguesit)

Disa fenomene mund të regjistrohen dhe të maten në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për shembull, në qoftë se ne jemi të interesuar për moshën, nivelin e të ardhurave, statusin martesor, numrin e fëmijëve, etj. Megjithatë, ekzistojnë disa dukuri të cilat nuk mund të vëzhgohen në mënyrë të drejtpërdrejt apo të maten. Për shembull, kënaqësia nga puna ose lumturia.

LËNDA E STUDIMIT	Paraqitja e lëndës: Indikatorët
Qëndrime	Deklarata (me shkrim ose me gojë); procedura; të dhënat për karakteristikat e dukurive të mjedisit natyror dhe shoqëror.
Ndjenja	Deklarata, gjeste, mimika, lëvizje, objekte materiale
Sjellja	Veprimet individuale dhe grupore; deklaratat;
Informimi	Deklarata që tregojnë sasinë e informacionit të saktë në lidhje me diçka, procedura të cilat janë tregues të ekzistimit (mos) të informacioneve për diçka;
Media (publiku)	Deklarata, sjellje (shikimi TV, leximi i gazetave, dëgjimi radios, prania në internet)
Media (përmbajtja)	Përmbajtja e shkruar (tekste), Përmbajtje me imazh (fotografi, postera, vizatime), përmbajtje audio-vizuale – shënime të filmuara
Institucione /organizata / Komunitete	dokumente (shënime me shkrim, vizuale dhe audio- vizuale); Deklarata; sjellja e individëve dhe grupeve
Norma	dokumente (shënime me shkrim, vizuale dhe audio- vizuale); Deklarata; sjellja e individëve dhe grupeve
Ngjarje	sjellja e individëve dhe grupeve, deklarata, gjeste, mimika, lëvizje, objekte materiale, lloje të ndryshme të artefakteve, simbole religjioze, gjësende të ndryshme, lloje të ndryshme të pajisjeve që përdoren gjatë një ngjarjeje, vepra artistike
“UNË” lëndë hulumtimi: personaliteti	Përvoja personale: përshtypjet personale (fotografi, ndjenja), shfaqjet, nocionet, qëndrimet, ndjenjat, ëndrrat

Ne si studiues nuk kemi qasje të drejtpërdrejtë në mendimet, dëshirat, shpresat, vlerësimet dhe pikëpamjet (qëndrimet) e njerëzve të tjerë, por kjo nuk do të thotë se ata nuk mund të maten.

Mënyrat me të cilat regjistrojmë dhe matim këto dukuri janë të ndryshme nga mënyrat e regjistrimit dhe matjes së drejtpërdrejtë të fenomeneve në dispozicion. Në këtë rast, mbështetemi në manifestime të jashtme (treguesit) e këtyre fenomeneve komplekse që nuk mund të regjistrohen dhe maten në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këto tregues të jashtëm quhen **indikator**. Indikatorët janë anë e jashtëzakonshme e një lënde (subjekti) të hulumtimit, ajo që u është në dispozicion shqisave tona (shikimit, prekjës, shijës, nuhatjes) dhe që mund të regjistrohet.

Duke përdorur indikatorët e tërthortë në mënyrë të drejtpërdrejtë formojmë një pamje të fenomenit që na intereson. Bazuar në deklaratat e subjektit, duke vëzhguar gjestet e tij, mimikën e tij të fytyrës dhe kështu me radhë. Për normat të cilat vlejné në ndonjë firmë ne konkludojmë në bazë të dokumenteve ose të sjelljes së punëtorëve. **Të dhënat** janë indikatorët që janë vërejtur (regjistruar), qoftë me ndihmën e shqisave ose përmes instrumenteve posaçërisht të projektuara (grumbullimit i të dhënave). Të dhënat e mbledhura analizohen dhe shërbejnë si bazë për hartimin e konkluzioneve në lidhje me dukurinë që është lëndë e hulumtimit.

Lloji i indikatorit përcakton edhe mënyrën se si ata regjistrohen (mbledhja e të dhënave). Kështu, për shembull, gjestet dhe shprehjet e fytyrës janë në dispozicion gjatë vëzhgimit të drejtpërdrejtë. Deklaratat e subjektit për vlerësimet e tij, dëshirat, shpresat, etj. hulumtuesi i mbledh duke u bazuar në intervista ose për këtë përdor pyetësor.

Llojet e treguesve / të dhënave	Teknikat për mbledhjen e të dhënave
Deklarata (me shkrim dhe me gojë);	Intervista/biseda; Pyetësor për intervista të thelluara; Fokus grupe
Veprimet individuale dhe grupe;	Vëzhgim, Anketim, intervistë; Grupe të fokusit; Analiza e përmbajtjes
Të dhëna për karakteristikat e mjedisit natyror dhe shoqëror;	Regjistrimet statistikore; matje tjera statistikore (shporta e konsumatorit, indeksi i çmimeve me pakicë, etj.)
Gjeste, mimika, lëvizje;	Vëzhgim
Sjellja (shikimi TV, leximi i gazetave, dëgjimi radio, prania në internet)	Intervistë; panele të mediave; grupet e fokusit
Përmbajtje e shkruar (tekst), përmbajtje me imazh (fotografi, postera, vizatime), Përmbajtje audio-vizuale (shënime të filmuara)	Analiza e përmbajtjes
Dokumente (me shkrim, me zë, shënime audio-vizuale);	Analiza e përmbajtjes
Llojet e ndryshme të artefakteve: simbole fetare, mjete të ndryshme të përdorura gjatë një ngjarjeje, vepra artistike	Vëzhgim; studime etnografike
Përvojë personale: përshtypje shqisore (fotografi, ndjenja), shfaqje, koncepte, qëndrime, ndjenja, ëndrra	Analizë e vetvetes; Diskutime në grup

Procedura metodologjike

- 1. Hulumtimi shkencor si proces komunikimi**
- 2. Hulumtimi shkencor si proces për zgjidhjen e problemeve**
 - 2.1 . Përkufizimi i përafërt i problemit hulumtues
 - 2.2 . Faza përgatitore e hulumtimit
 - 2.3 . Projektimi i hulumtimit
 - 2.4 . Zhvillimi i instrumenteve
 - 2.5 . Realizimi i hulumtimit
 - 2.6 . Përpunimi dhe analizimi i të dhënave
 - 2.7 . Shkrimi i raportit hulumtues

Procedura metodologjike

Hulumtimi shkencor paraqet një proces që përbëhet nga zgjidhja e problemeve të shumëllojshme intelektuale, nder personale dhe praktike. Kërkimi shkencor më shpesh është definuar si aktivitet që synon zgjidhjen e problemeve njohëse (qëllimi është arritja deri te dituria), por, në të njëjtën kohë, hulumtimi është edhe aktivitet social - **proces komunikimi** ndërmjet subjekteve të ndryshme të përfshirë në proces (procesin e kërkimit). Në këtë kuptim, hulumtimi shkencor mund të vështrohet si:

- proces komunikimi, dhe si
- proces i zgjidhjes së problemeve.

1. Hulumtimi shkencor si proces komunikimi

Studimet shkencore domosdoshmërisht duhet të përfshijnë një numër të aktorëve (sidomos ato hulumtime që bazohen në mostrën kërkimore) dhe nënkuptojnë zgjidhjen e shumë problemeve praktike dhe ndër personale.

Në hulumtim shkencor pjesëmarrës janë: porositësi, hulumtuesi, intervistuesi dhe i intervistuari. Një aktor mund të ketë një ose më shumë role dhe secili rol mund të ketë një ose më shumë aktorë. Për efikasitetin e studimit vendimtar është ndërveprimi (interaksioni), d.m.th. komunikimi mes aktorëve të ndryshëm të cilët bartin (interpretojnë) rolet në hulumtim.

Operacionet themelore të komunikimit në kërkimin shkencor:

- 1) **Porositësi** ja komunikon problemin **hulumtuesit** (përcakton problematikën në bazë të së cilës hulumtuesi përpilon një skicë ideore (konceptuale).
- 2) **Hulumtuesi** organizon punën në kuptimin e planifikimit dhe organizimit të hulumtimit (përpilon skicën ideore), zhvillon dhe teston instrumentet kërkimore dhe përgatitën **ekzaminuesit** për punët me të anketuarit (p.sh. harton Manual për ekzaminuesin).
- 3) **Ekzaminuesi** vendosën kontakte me të anketuarit, i motivon ata që të marrin pjesë në hulumtim dhe jep udhëzime (përpiqet të siguroj procedurë standarde të testimit).
- 4) **I anketuari** pranon pjesëmarrjen në studim dhe vepron sipas udhëzimeve të marra nga **ekzaminuesi** (plotëson pyetësin, zgjidh testin, etj.).
- 5) **Ekzaminuesi** i dorëzon materialin e mbledhur **hulumtuesit** (pyetësorët e mbushur, protokollet e intervistave, etj.)

- 6) **Hulumtuesi** i përpunon të dhënat dhe **porositësit** i ja komunikon gjetjet (rezultatet) dhe konkluzionet e hulumtimit, i formulon rekomandimet për zgjidhjen e problemit (Harton Raportin e Hulumtimit).
- 7) **Porositësi** ndërmerr masat e rekomanduara dhe së bashku me **hulumtuesin** shqyrton efektet e masave të ndërmarra.

Hulumtuesi fillon nga detyra e projektit, analizon të gjitha konsekuencat (pasoja) e saja teorike, metodologjike dhe financiare për të përpiluar një skicë fillestare (draft fillestar). **Skica fillestare** paraqet një dokument i cili përcakton se të dyja palët bien dakord (porositësi dhe hulumtuesi) mbi atë se cili është objekti i hulumtimit, i cilit karakter do të jetë hulumtimi, cilët janë efektet e pritshme, koha, çmimi i hulumtimit, etj. Prandaj, roli i skicës ideore është që të mënjanojë çdo keqkuptim të mundshëm në komunikim ndërmjet hulumtuesit dhe porositësit (në lidhje me atë se çfarë është objekt i hulumtimit, cili është afati i realizimit të hulumtimit, cili është çmimi, etj.). *Projekti hulumtimit* përpilohet në bazë të skicës ideore dhe përfshin definimin e të gjithë elementeve më të rëndësishme të hulumtimit: lënda e hulumtimit, qëllimet, detyrat, metodat dhe teknikat e hulumtimit, definimin e mostrës, parashtrimin e hipotezave dhe kështu me radhë.

2. Hulumtimi shkencore si proces për zgjidhjen e problemit

Në esencë veprimtaria kërkimore është aktivitet për arritjen deri te njohuritë e reja ose zgjidhjen e problemeve teorike ose praktike. Parë në këtë mënyrë, hulumtimin mund ta definojmë si proces për zgjidhjen e problemeve njohëse dhe praktike. Ky proces ka faza të caktuara të përbashkëta: Fazat e procesit për zgjidhjen e problemeve njohëse dhe/ose praktike (d.m.th. të hulumtimit)

1	Përcaktimi i kornizës së problemit të hulumtimit	Identifikimi i problemit dhe marrja e vendimit për hulumtim
2	Faza përgatitore	Puna në bibliotekë dhe në terren
3	Dizajni (projektimi) i hulumtimit	Formulimi i problemit dhe hipotezave, specifikimi i metodave dhe teknikave (harton skicën ideore dhe dizajnon projektin hulumtues)
4	Zhvillimi i instrumenteve	Pyetësorët, shkallët matëse, testet, protokollet...
5	Realizimi i hulumtimit	Organizimi i hulumtimit, sigurimi i kushteve standarde për regjistrimin e të dhënave përmes instrumenteve (Pyetësorët, shkallët matëse, testet, etj.)
6	Përpunimi dhe analiza e të dhënave	Rregullimi i përgjigjeve të marra, përpunimi statistikor, analiza e të dhënave të marra.
7	Shkrimi i Raportit hulumtues	Interpretimi i rezultateve (gjetjeve), nxjerrja e konkluzioneve, shkrimi i raportit, rekomandimeve etj.

2.1. Përkufizimi i kornizës së problemit hulumtues

Kur studiuesi gjendet përpara një problemi kognitiv (njohës) ose praktik që duhet të hulumtohet, ai përballet me pyetjen se cilës *fushë shkencore* më të afërt problemi i takon. Të përcaktohet korniza e problemit nënkuptojmë të identifikojmë fushën shkencore brenda të cilës problemi ka kuptim dhe domethënie të caktuar. Kështu që, fusha shkencore e afërt në të cilën është i vendosur problemi bëhet kontekst teorik, konceptual dhe metodologjik i hulumtimit të problemit.

Për shembull. Nëse është fjala për sjelljen e një individi në punë, ajo (sjellja), mund të jetë lëndë (subjekt) e hulumtimit e disiplinave të ndryshme shkencore: biologji, mjekësi, sociologji, psikologji, etj. Nëse bëhet fjalë për *sjellje konfliktuale*, atëherë problemi ngushtohet në psikologji ose eventualisht në Sociologji varësisht prej asaj nëse nxitësin (shkakun) e kësaj sjellje e kërkojmë te një individ ose në rrethinën e tij. Nëse për shembull shkakët e sjelljes konfliktuale i kërkojmë te një individ atëherë psikologjia do të jetë konteksti ynë teorik, konceptual dhe metodologjik për studimin e problemit të dhënë. Me fjalë të tjera, gjithçka që deri më tani ka dhënë teoria e personalitetit bëhet konteksti teorik, konceptual dhe metodologjik në të cilën vendoset hulumtimi.

2.2. Faza përgatitore e hulumtimit

Faza përgatitore e hulumtimit përfshin njohjen e dukurisë (fenomenit) që dëshirohet të hulumtohet dhe realizohet në tre drejtime kryesore: rishikimi i literaturës relevante profesionale dhe shkencore; njohja e drejtpërdrejtë në terren me llojet e ndryshme të fenomenit që është objekt i hulumtimit; përcaktimi i kushteve materiale të nevojshme për realizimin e hulumtimit. Me fjalë të tjera, faza përgatitore përfshin: (1) punë në biblioteka, (2) punë në terren, dhe (3) hartimi i skicës ideore të hulumtimit.

2.3. Puna në bibliotekë

Përfshin mbledhjen e *informacioneve mbi studimet e mëparshme* të problemeve të njëjta ose të ngjashme, rezultatet e këtyre studimeve, metodat dhe instrumentet e përdorura të hulumtimit dhe ngjashëm. Shkenca është sistem i njohurive që vazhdimisht mbi ndërtohet dhe prandaj, edhe hulumtimi ynë duhet të fillojë nga ajo që shkenca tashmë ka zbuluar dhe vërtetuar (shih parimin: njohuri shkencore sistematike).

Deri te literatura e nevojshme është më lehtë për tu arritur duke përdorur: (a) katalogun e bibliotekës (në katalogun e bibliotekës njësitë e bibliotekës së pari janë të klasifikuara sipas fushës shkencore dhe në kuadër të tyre në degë dhe fusha tematike), (b) Bibliografi (bibliografitë përpilohen për një periudhë të caktuar, fusha dhe lëndë shkencore), (c) revista me referencë (zakonisht përmbajnë përmbledhje që siguron qasje të shpejtë në përmbajtjen e punimit), (d) interneti, etj.

Për nga ajo se sa janë të drejtpërdrejta burimet e informacionit, mund t'i klasifikojmë në:

- 1) **Burime të rendit të parë (burime primare)** janë burimet më të drejtpërdrejta të informacionit. Shembuj të këtyre burimeve janë veprat origjinale, të cilat paraqesin pasqyrë të hulumtimit nga ana e vetë autorit dhe ato botohen në revista dhe anale shkencore.
- 2) **Burime të rendit të dytë (burime sekondare)** janë më pak të drejtpërdrejta nga burimet primare dhe janë të përgatitura mbi bazën e tyre. Shembuj të këtyre burimeve janë analet, që mundësojnë një pasqyrë të shpejtë në ndonjë fushë dhe sintezë të punimeve primare.
- 3) **Burime të rendit të tretë (burime terciare)** janë burime të hartuara mbi bazën e burimeve sekondare. Shembull i këtyre burimeve janë librat, që paraqesin një sintezë si të burimeve primare ashtu edhe të atyre sekondare të informacionit. Lexuesi prej librave shpesh merr informacione të dorës së tretë, d.m.th. burimi primar është "i filtruar" nëpërmjet interpretimit të autorit të artikullit të shqyrtuar dhe autorit të librit.
- 4) **Burime të rendit të katërt.** Për shembull, artikujt e revistave përmbajnë pasqyrë të përmbajtjes së librave.
- 5) **Burime të rendit të pestë.** Diskutimi i informacioneve të rendit të katërt, për shembull, diskutimi me një kolegë.

2.4. Puna në terren

I mundëson hulumtuesit që të njoftohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrethanat natyrore të manifestimit të fenomeneve që është lëndë e studimit. Puna në terren mund të përfshijë diskutime me ekspertë (Ata që kanë qasje të mirë mbi problemin), qasje në të dhënat lokale, shqyrtimi i dukurisë në kushtet natyrore dhe ngjashëm.

2.5. Hartimi i skicës ideore të hulumtimit

Skica ideore duhet të përgjigjet në tre pyetjet themelore: (1) çfarë do të jetë lëndë dhe problem i hulumtimit, (2) si do të realizohet hulumtimi, (3) cilat janë supozimet materiale për realizimin e hulumtimit. Struktura e skicës ideore (konceptuale)

- Problemi, qëllimi dhe detyrat e hulumtimit

Hulumtuesi përcakton problemin, qëllimin dhe detyrat e hulumtimit dhe me këtë tregon mënyrën se si ai e ka kuptuar problemin që e ka theksuar porosinë, dhe si duket ai problem kur formulohet me terma shkencore.

- Qasjet e mundshme metodologjike
Përshkruhen metodat, teknikat dhe instrumentet që duhet të ndërtohen dhe përdoren në hulumtim. Parashikohet madhësia e mostrës dhe vëllimi i hulumtimit (popullimi).
- Koha, stafi dhe mjetet e nevojshme
Parashikohen aktivitetet themelore hulumtuese, korniza kohore e tyre dhe mjetet e nevojshme për realizimin e aktiviteteve.

Duke pasur parasysh qëllimin e saj, që të largoj dykuptimësitë potenciale në komunikim mes porositesit dhe hulumtuesit, skica ideore duhet të jetë e shkruar shumë qartë, thjesht dhe në mënyrë maksimale e qartë. Skice ideore nuk duhet të jetë e detajuar, pasi ajo është bazë për përpilimin e detajuar të projektit kërkimor.

Për shembull, kapitujt e skicës ideore (konceptuale).

Instituti i Edukimit
Republika e Kosovës
Departamenti për Hulumtim dhe Zhvillim

Hulumtimi i opinionëve, qëndrimeve dhe njohurive të studentëve, profesorëve dhe prindërve rreth shpërndarjes dhe formave të korrupsionit në institucionet arsimore

(skicë e projektit me plan të veprimit dhe buxhetin e projektit - skica ideore)

Realizuesi i projektit:

Me këtë dokument projektohen aktivitetet dhe Buxheti i hulumtimit të mendimeve, qëndrimeve dhe njohurive të studentëve, profesorëve dhe prindërve në lidhje me shpërndarjen dhe llojet e korrupsionit në institucionet arsimore. Në dokument është e përcaktuar baza fillestare (Strategjia dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër Korrupsionit në arsim), nocioni i korrupsionit, si dhe aktivitetet metodologjike dhe praktike që duhet të realizohen, si dhe një pasqyrë e mjeteve materiale të nevojshme për realizimin e suksesshëm të projektit.

2.6. Dizajni i hulumtimit

Dizajni (projektimi) i hulumtimit është një proces gjatë të cilit studiuesi merr vendime për të gjitha çështjet e rëndësishme në lidhje me realizimin e hulumtimit. Çdo projekt në një farë

mënyre është unik, origjinal por edhe tipik, karakteristik për një lloji të caktuar dhe lloj të hulumtimit.

2.7. Zhvillimi i instrumenteve

Pas projektimit të hulumtimit kalohet në krijimin e instrumenteve të hulumtimit. Që të vëzhgohet dhe regjistrohet një dukuri e caktuar është e nevojshme që të zhvillohen apo të adoptohen instrumentet ekzistuese për grumbullimin e të dhënave (pyetësorë, teste, shkalla matëse të vlerësimit, protokolle të intervistimit etj.).

2.8. Realizimi i hulumtimit

Te hulumtimet e mëdha përpara realizimit final kryhen hulumtime preliminare (paraprake). Hulumtimet paraprake realizohen me një mostër prej 5% deri në 10 % të madhësisë së mostrës së planifikuar për hulumtimin përfundimtar dhe ka funksionet: (1) që të testoj instrumentet kërkimore, dhe (2) që të kontrolloj organizimin hulumtues.

2.9. Përpunimi dhe analiza e të dhënave

Pas realizimit të hulumtimit, të dhënat futen në një bazë të dhënash të përgatitur paraprakisht dhe fillimisht analizohen në mënyrë statistikore dhe pastaj analizohen në mënyrë logjike. Të dhënat e mbledhura vendosen në raport me hipotezën e propozuar, me cilën gjë ajo konfirmohet (pranohet) ose refuzohet. Analiza statistikore dhe mënyrat e analizës statistikore do të shqyrtohen në kapitujt e më vonshëm.

Raporti zakonisht ka një strukturë të caktuar logjike të përmbajtjes:

- Emërtimi (identifikimi) i raportit - titulli i raportit; emri dhe mbiemri i hulumtuesve dhe i bashkëpunëtorëve nëse ka pas, emri i plotë i institucionit ku hulumtimi është realizuar; Përmbledhje (Rezyme) prej 150 deri në 300 fjalë; lista e fjalëve kyçe;
- Hyrje – korniza e definimit të problemit; theksimi i qëllimit të përbashkët dhe pritjet nga kërkimi;
- Lënda e hulumtimit - Përcaktimi i saktë i përmbajtjes së hulumtimit, definimi i nocioneve themelore, parashtrimi i hipotezave kërkimore;
- Procedura e hulumtimit - shpjegimi i zgjedhjes së metodave dhe teknikave hulumtuese të përdorura për mbledhjen dhe përpunimi e të dhënave;
- Përfundimet e hulumtimit - Pjesa më e madhe përfshin një paraqitje sistematike dhe analizë të rezultateve të hulumtimit; diskutimi dhe interpretimi i gjetjeve (rezultateve);
- Gjetjet e hulumtimit - pjesë në të cilën paraqiten dhe diskutohen konkluzionet e përgjithshme dhe specifike kërkimore;
- Literatura;
- Shtojca (Aneks).

Projekti i hulumtimit kryesisht përbëhet nga tre pjesë kryesore: (1) pjesa teorike, (2) pjesa metodologjike dhe (3) pjesa financiare e projektit.

1. Pjesa teorike e projektit
 - 1.1. Formulimi i problemit
 - 1.2. Përkufizimi i koncepteve themelore
 - 1.3. Definimi i qëllimit të hulumtimit
 - 1.4. Formulimi i hipotezës së përgjithshme dhe hipotezave të veçanta
2. Metodologjia e projektit
 - 2.1. Përzgjedhja e metodave të përgjithshme të kërkimit
 - 2.2. Përkufizim i variablave operacionale
 - 2.3. Zgjedhja e teknikës për mbledhjen e të dhënave
 - 2.4. Mostra
 - 2.5. Plani për përpunimin e të dhënave
 - 2.6. Plani i realizimit të hulumtimit
3. Pjesa materiale e projektit

1. Pjesa teorike e projektit

Aktivitetet kryesore për zhvillimin e pjesës teorike të projektit janë: (1) formulimi i problemit kërkimor, (2) vendosja e qëllimit kërkimor, (3) formulimi i hipotezës së përgjithshme dhe të hipotezave të veçanta dhe detyrave kërkimore, (4) analiza e nocioneve kyçe (klasifikimi dhe përkufizimi i variablave).

1.1. Formulimi i problemit

Pika kritike e çdo hulumtimi është zbulimi i boshllëqeve, paqartësive, vështirësive, problemit që duhet të zgjidhet. Njohuritë e mëparshme dhe përvoja luajnë një rol të madh në identifikimin dhe përcaktimin e problemit. Prandaj, prej hulumtuesit pritet që së pari, në mënyrë teorike të analizoj problemin dhe pastaj në mënyrë të qartë ta formuloj.

Analiza teorike e problemit nënkupton në mënyrë sistematike të ekspozohen mënyrat se si janë qasur këtij problemi hulumtuesit në studimet e mëparshme, cila procedurë metodologjike është aplikuar, cilat rezultate janë arritur, cilat pyetje kanë mbetur të hapura. Me fjalë të tjera, hulumtuesi analizon, vlerëson dhe sintetizon (përmbledh) të gjitha informatat dhe njohuritë në lidhje me problemin që ai hulumton.

Problemi formuluar shkencërisht shpreh një raport (lidhje) në mes dy apo më shumë dukurive. Problemi mund të formulohet në formën e një pyetje apo deklaratë për atë se cilët dukuri janë objekt i hulumtimit. Për shembull: *Sa është i përhapur korrupsioni në institucionet arsimore sipas mendimit të studentëve, profesorëve dhe prindërve dhe cilët janë llojet kryesore të manifestimit të tij.* Në të vërtetë, i gjithë hulumtimi është zgjidhje të problemit të vendosur, apo përgjigje në pyetjen e parashtruar.

1. Përkufizimi i koncepteve themelore

Në hulumtime, veçanërisht në ato empirike, është e nevojshme që të përcaktohen saktësisht fenomenet që hulumtohen. Shpesh në përcaktimin e disa prej fenomeneve komplekse ekzistojnë dallimet në mes të shkollave, autorëve dhe qasjeve të ndryshme. Të fillohet hulumtimi pa definicione të qarta të nocioneve mund të shkaktojë konfuzion të madh. Për këtë arsye, studiuesit janë të detyruar që të: (1) të theksojnë qasjet themelore në përcaktimin e nocioneve themelore, (2) të theksojnë përcaktimin e vetë, ose të japin definicionin e tyre i cili ndryshon nga ato ekzistuese; (3) të arsyetojnë zgjedhjen e tyre.

Për shembull, ne mund të përcaktojmë klasën shoqërore si një grup i njerëzve i cili ndryshon për nga pozita në shoqëri, për nga shuma e pasurisë materiale, sipas lartësisë së të ardhurave, për nga stili i jetesës dhe ndikimit social i anëtarëve të saj.

1.3. Vendosja e qëllimit të hulumtimit

Hapi i ardhshëm në konkretizimin e problemit paraqet përcaktimi i qëllimeve të hulumtimit. Qëllim i hulumtimit është që të zbulohet ajo që është lëndë e hulumtimit.

Shembull, i përcaktimit të qëllimit të hulumtimit.

Qëllim i përgjithshëm i hulumtimit është që të përcaktohen qëndrimet, mendimet dhe njohuritë e studentëve, profesorëve dhe prindërve në institucionet arsimore për:

- sa është i pranishëm korrupsioni në shoqërinë tonë (në Kosovë);
- në cilat veprimtari dhe profesione korrupsioni është veçanërisht i pranishëm;
- sa është i përhapur korrupsioni në institucionet arsimore (kolegje, universitete);
- vlerësimi prirjes së grupeve të ndryshme në arsim ndaj korrupsionit;
- cilat janë veprimet më të shpeshta të korrupsionit në institucionet arsimore;
- cili është qëndrimi ynë personal ndaj korrupsionit dhe sa jemi të gatshëm për të raportuar korrupsionin;
- cilave autoritetet duhet tua raportojmë korrupsionin;
- përfshirja e vetë në korrupsion;
- përfaqësimi i problemit (korrupsionit) në publik dhe plan programin shkollor;
- në cilën shkallë është e mundur që të zvogëlohet korrupsioni, me cilat masa dhe kush është më përgjegjës për të.

Lëndë e hulumtimit janë mendimet, qëndrimet dhe njohuritë e studentëve, profesorëve dhe prindërve në lidhje me shtrirjen dhe format e korrupsionit në institucionet arsimore.

1.4. Formulimi i hipotezave të përgjithshme dhe të veçanta

Në hapin tjetër të përpunimit të problemit paraqitet ideja për zgjidhjen e problemit (hipoteza e hulumtimit). Hipoteza paraqet supozim për marrëdhëniet midis elementeve të fenomenit të hulumtuar, ose për lidhjen në mes asaj dukurie dhe një dukurie tjetër. Funkcioni i hipotezës është që të hulumtimin ta drejtoj në kërkim të asaj nëse ndërmjet elementeve të dukurisë, ose në mes të dukurisë dhe një dukurie tjetër ekziston lloji i rregullsisë që ajo (hipoteza) specifikon (Cohen dhe Nagel, 221). **Detyrë e hulumtimit** është që të vërtetohet nëse ai lloj specifik i marrëdhënieve midis fakteve përgjigjet në pyetjen e parashtruar, nëse kjo është zgjidhje e problemit (Cohen dhe Nagel, 221).

Hipotezat për shembull mund të jenë si në vijim:

- përvojat nga fëmijëria e hershme përcaktojnë disa karakteristika të individit në moshën e rritur,
- statusi social i njerëzve përcakton interesat dhe vlerat e tyre,
- efikasiteti i grupit kontribuon në kohezionin e tij,
- shpërblimi ndikon në sjelljen e vazhdueshme të shpërblyer

Me hipotezë nënkuptojmë supozimin të bazuar shkencërisht për tiparet ende të panjohura të lëndës (subjektit) së hulumtimi. Ky supozim (hipoteza) vërtetohet gjatë hulumtimit dhe në varësi të rezultateve pranohet, pjesërisht pranohet ose refuzohet. Hipotezat mund të klasifikohen sipas karakteristikave të tyre në:

Hipoteza të thjeshta dhe komplekse

Sipas numrit të ndryshoreve (variabla) marrëdhënia e të cilëve në to supozohet që mund të ndahet në hipoteza të thjeshta dhe komplekse. Të thjeshta janë ato që supozojnë raportin (lidhjen) në mes dy variabla (p.sh. niveli më i lartë i arsimit do të thotë nivel më i ulët i pranimi të botëkuptimeve radikale); **hipotezat komplekse** supozojnë marrëdhëniet në mes të një numri më të madh të variabla (p.sh. me rritjen e moshës dhe uljen e viteve të shkollimit rritet shkalla e pranimi të botëkuptimin radikal).

Hipotezat përshkruese, të lidhjes dhe hipotezat shkakësore

Sipas llojeve të qëllimeve që janë të vendosura, hipotezat mund t'i klasifikojmë në përshkruese, hipoteza që flasin për lidhshmërinë dhe hipoteza për marrëdhënie shkak-pasojë. **Hipotezat përshkruese** supozojnë se cilat janë vetitë, respektivisht karakteristikat e një dukurie (p.sh. për rolin e prituri të shtetit në mbrojtjen e të varfërve, ose, si njerëzit i shohin të drejtat e grave); **hipoteza për lidhshmërinë** e disa dukurive të cilat nuk mund të provohet një marrëdhënie shkakësore (p.sh. ekzistimi i lidhjes në mes numrit të maceve të zeza dhe aksidenteve në komunikacion, ose të majtët radikalë dhe të djathtët radikalë kanë pikëpamje të ngjashme për marrëdhëniet ideale në shoqëri). **Hipoteza për marrëdhëniet shkak-pasojë (kauzale, shkakësore)** supozon që një dukuri shkakton një dukuri tjetër (p.sh. sa më i madh të jetë presioni i jashtëm aq më i madh është kohezioni i grupit).

Hipoteza zero dhe hipoteza kërkimore (alternative)

Në anketat statistikore zakonisht testohet e a. q. **hipoteza zero**. Për shembull, nëse hulumtojmë lidhjen në mes dy variabla (mosha dhe periudha në shërbim) do të nisemi nga supozimi që në mes variabla nuk ka asnjë lidhje. Ky supozim do të refuzohet vetëm në qoftë se jemi të sigurt (me probabilitet më të lartë se 95 % ose 99 %) se supozimi është i gabuar. **Hipoteza e hulumtimit** (hipoteza alternative) që ne fakt ne e hulumtojmë dhe duam që të provojë me

hedhjen (mos pranimin) e hipotezës zero në këtë rast është se me rritjen e moshës, rriten edhe vitet e shërbimit.

Hipotezat teorike dhe empirike

Në varësi të mënyrës së verifikimit (metodës së hulumtimit) dallojmë hipotezë teorike dhe empirike. **Hipotezën teorike** e testojmë me analizë teorike, me analizë logjike të argumenteve për ose kundër saj, ndërsa **hipoteza empirike** pranohet ose refuzohet në bazë të provave mbledhura empirike.

Hipoteza të përgjithshme dhe të veçanta

Në kuadër të një hulumtimi zakonisht vendoset një numër më i madh të hipotezave që janë me shkallë të ndryshme të parimit të përgjithshëm. **Hipoteza e përgjithshme** ka të bëjë me tërë lëndën e hulumtimit dhe përfshin të gjithë aspektet e saj. Kjo hipotezë e përgjithshme zakonisht ndahet në **hipoteza të veçanta** (specifike) që përfshijnë aspekte të ndryshme të problemit të hulumtimit. Hipotezat specifike janë konkrete dhe mund të testohen, d.m.th. mund të vërtetohet (provohet) saktësia e tyre.

Për shembull, përkatësia në një klasë sociale është e lidhur me pamjen e ndryshme në çështjet më të rëndësishme shoqërore dhe politike dhe në pranimin e vlerave të caktuara shoqërore (Kjo hipotezë e përgjithshme është e përpunuar më tej në hipoteza të veçanta).

- në mes anëtarëve të klasave të ndryshme shoqërore, ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në shkallën e pranimin të mendimit se shteti duhet të kujdeset që çdo individ t'i siguroj mjete për jetë.
- mes anëtarëve të klasave të ndryshme shoqërore ekziston dallim i rëndësishëm në shkallën e pranimin të mendimit se disa individ munden pakufi të pasurohen dhe shteti nuk duhet të përzihet. Etj.

2. Pjesa metodologjike e projektit

Pas formulimit të problemit, vendosjes së qëllimeve dhe hipotezave, dhe pas definimit të nocioneve dhe variablave, kalohet në pjesën e metodologjisë së projektit, i cili përfshin: (1) përzgjedhjen e metodës së përgjithshme të organizimit të hulumtimit, (2) definimi operacional i variablave, (3) zgjedhja e teknikave për mbledhjen e të dhënave, (4) përcaktimi i mostrës (kampionit), (5) zhvillimi i planit për përpunimin e të dhënave; (6) zhvillimi i planit për realizimin e hulumtimit.

2.1. Përzgjedhja e metodës së përgjithshme të hulumtimit

Nëse lëmë anash hulumtimin teorik, hulumtuesit mund të zgjedhin një nga dy mënyrat e përgjithshme empirike metodologjike. Gjegjësisht, ato mund të vendosin për realizim të hulumtimit eksperimental ose jo-eksperimental. Brenda kategorisë së hulumtimeve eksperimentale llojet kryesore janë **eksperimenti laboratorik** dhe **eksperimenti në kushte natyrore**. Hulumtimet jo-eksperimentale mund të klasifikohen në **anketime të popullatës** dhe hulumtime në terren në komunitetet lokale. Për metodat e hulumtimit më gjerë do të flitet në kapitujt në vijim.

2.2. Përkufizim operacional i ndryshoreve (variablave)

Vetëm përkufizimi (definimi) teorik i dukurive në hulumtimet empirike nuk është i mjaftueshëm. Në hulumtimet empirike dukuritë duhet të maten. Matja është qëllimi i çdo shkence dhe që ajo të realizohet është e nevojshme që variablat të përgatiten dhe të jenë në dispozicion për matje. Për shembull, si të maten ndjenjat e dikujt, kënaqësia nga puna, apo nga stili i jetesës. Detyrë (funksion) i përkufizimit operacional është që të përcaktoj ndryshoret në mënyrë që mundëson zgjedhjen ose përpilimin e teknikave të përshtatshme për nxitjen, vëzhgimin dhe matjen e saj.

Për shembull, “stili i jetës” (si përcaktues i klasës shoqërore) që të mund të matet duhet të definohet në mënyrë operative, për shembull si: a) mënyra se si njerëzit e përdorin kohën e lirë (në mënyrë aktive, duke u marrë me sport, me lexim apo pasive duke shikuar TV, duke fjetur, b) mënyra se si ata vishen, c) lloj i muzikës që e dëgjojnë, filmat i shohin... Në këtë mënyrë konkrete të definuar stilet e jetës mundësojnë që përmes pyetjeve përkatëse nga pyetësi të anketuarit të klasifikohen në klasa.

Çdo tipar që manifestohet në shkallë të ndryshme, secila madhësi e cila rrite ose ulet në terminologjinë hulumtuese quhet **ndryshore** ose **variabël**. Në shembullin tonë, në nivel të hipotezave specifike kemi dy dukuri që mund të përfaqësohen në mënyrë të qartë si ndryshore dhe **lidhja reciproke** e të cilave mund të matet me saktësi statistikore.

për shembull:

- në mes anëtarëve të klasave të ndryshme shoqërore, ekziston dallim i rëndësishëm në shkallën e pranimi të mendimit se shteti duhet të kujdeset që çdo individ t'i siguroj mjete për jetë.

Operacionalizimi i lëndës së hulumtimit nënkupton që për çdo variabël në hipotezë të përcaktohen **indiktorët**, d.m.th. llojet e të dhënave deri te të cilat me hulumtim mund të arrihet. Me operacionalizimin e variablave, krijohet mundësi për regjistrimin dhe matjen e tyre. Për shembull në bazë të përkufizimit operacional të nocionit **klasë** (sasia e pasurisë materiale,

lartësia e të ardhurave, ndikimi shoqëror ...) të anketuarit mund të klasifikohen në shkallë shoqërore (klasa e lartë, e lartë e mesme, e mesme, e mesme e ulët dhe klasa e ulët). Në anën tjetër, të anketuarit mund t'i radhisim sipas shkallës së pajtimit ose të qenit dakord me pretendimin se shteti duhet të kujdeset që çdo individ t'i sigurojë mjete për jetesë (një ato që plotësisht pajtohen, pjesërisht pajtohen, janë neutral, nuk pajtohen, plotësisht nuk pajtohen).

2.3. Zgjedhja e teknikave për mbledhjen e të dhënave

Në shkencat shoqërore shfrytëzohen tre grupe kryesore të mënyrave ose teknikave të hulumtimit. Për teknikat e hulumtimit në detaje do të diskutohet në kapitujt e mëvonshëm. Në grupin e parë bëjnë pjesë teknikat e ndryshme të **vëzhgimit të drejtpërdrejtë**. Grupi i dytë përbëhet nga teknikat e bazuara në **komunikimin verbal** me gojë me ose me shkrim (intervistë, pyetësor, shkallë vlerësimi). Në grupin e tretë përfshihen teknikat për **analizë të përmbajtjes** (porosive, dokumenteve, ligjeve, komunikimeve, mediave, etj.).

Në varësi të përkufizimit operacional të ndryshoreve, d.m.th. prej indikatorëve të përcaktuar vendosemi për një lloj të caktuar teknikës për mbledhjen e të dhënave.

Llojet e treguesve	Teknikat për mbledhjen e të dhënave
Deklarata (me shkrim dhe me gojë);	Intervista/biseda; Pyetësori për intervistë të thelluar, Grupet e fokusit
Sjellja e individëve dhe grupeve	Vëzhgim, anketë, intervistë, grupe të fokusit, analiza e përmbajtjes
Të dhëna për rrethinën natyrore dhe shoqërore	Regjistrime statistikore, matje tjera statistikore (shporta e konsumatorit, indeksi i çmimeve të shitjes me pakicë, etj.)
Gjeste, mimika, lëvizje	Vëzhgim
Sjellja (shikimi në televizor, leximi i gazetave, dëgjimi i radios, kyçja në internet)	Intervistë, panelet në media, grupet e fokusit
Përmbajtja e shkruar (tekst) përmbajtje në fotografi (fotografi, postera, vizatime), përmbajtje audio-vizuale (të dhëna filmike)	Analiza e përmbajtjes
Dokumente (me shkrim, audio dhe audio - vizuale);	Analiza e përmbajtjes
Lloje të ndryshme të artefakteve: simbole fetare, objekte rituale, lloje të ndryshme të mjeteve të përdorura gjatë një ngjarjeje, vepra arti	Vëzhgim, studime etnografike
Përvoja personale: përshtypje shqisore (fotografi, ndjenja), shfaqje, koncepte, qëndrime, ndjenja, ëndrra	Analizë e vetvetes, diskutime në grup

2.4. Përcaktimi i mostrës kërkimore

Përcaktimi i mostrës kërkimore paraqet një çështje që është veçanërisht e rëndësishme për hulumtime që kanë për qëllim të studiojnë fenomenin në popullimin e përgjithshme apo në segmente të veçanta të saj. Në hulumtimet eksperimentale në përgjithësi shfrytëzohen grupe të vogla të të anketuarve homogjen për të gjithë karakteristikat themelore (gjinia, mosha, niveli arsimit, etj.). Në hulumtimet jo-eksperimentale çështjet e popullimit dhe mostrës janë të rëndësishme thelbësore dhe për këtë arsye për ato mendohet si për detyra të veçanta kërkimore. Për popullimin dhe mostrën do të bëhet fjalë në kapitujt në vijim.

2.5. Plani për përpunimin e të dhënave

Nënkupton zgjedhjen e teknikave dhe procedurave statistikore për përpunimin e të dhënave. Pyetja më e rëndësishme që duhet bërë këtu është se me cilën metodë statistikore mund (duhet) të përpunohen të dhënat e mbledhura. Zgjedhja e metodave statistikore varet nga niveli i matjes që kemi arritur në hulumtim. Për nivelet e matjes do të shpjegohet në kapitujt e mëvonshëm.

2.6. Plani për realizimin e hulumtimit

Përfshin krijimin e kalendarit të hulumtimit dhe specifikimin e aktiviteteve të caktuara në hulumtim. (Kush, kur ...).

2. Pjesa materiale e projektit

Përfshin planifikimin e burimeve financiare për realizimin e hulumtimit (pajisje, instrumente, puna në terren...). Buxheti i projektit është shumë i rëndësishëm, sepse nëse ne nuk parashikohen saktë mjetet, i tërë hulumtimi mund të vihet në dyshim.

Shembull: buxheti i projektit

Aktivitetet	Përshkrimi i aktiviteteve	Euro
Analiza e rezultateve të hulumtimeve të kaluara në Kosovë	- Analiza e literaturës dhe burimeve të tjera në mënyrë që të identifikohen hulumtimet për korrupsionin në arsim - Analiza e hulumtimeve të realizuara deri më tani	
Projektimi i hulumtimit	- Përcaktimi i qëllimit të hulumtimit - Definimi i lëndës së hulumtimit - Analiza e burimeve dhe përcaktimi i popullimit kërkimor (numri i studentëve, profesorëve... Kosovë) - Përkufizimi i saktë i mostrës kërkimore	300 Konsulenti

	▪ Përcaktimi i metodave statistikore për analizën e të dhënave	700
Hartimi dhe para testimi i pyetësorëve (anketave)	▪ Hartimi i një serie të pyetjeve në përputhje me qëllimet dhe lëndën e hulumtimit ▪ Hartimi i pyetësorit për studentët ▪ Hartimi i pyetësorit për profesorët ▪ Hartimi i pyetësorit për prindërit ▪ Para testimi i pyetësorit në mostër prej 50+50+50 të anketuarve ▪ Përgatitja (shtypja) e versionit final të pyetësorit	500
Konstatimi i kalendarit të hulumtimit	▪ Hartimi i Kalendarit të hulumtimit	100
Trajnimi anketuesve	▪ Të realizohen konsultime një-ditore me anketuesit	300
Realizimi i hulumtimit	▪ Vizita në shkollë nga anketuesit ▪ Organizimi i plotësimit të pyetësorëve ▪ Dorëzimi i pyetësorëve të plotësuar	1800
Regjistrimi i të dhënave	▪ Hapja e bazës së të dhënave në SPSS ▪ Futja e të dhënave në bazën e të dhënave	500
Analiza statistikore e të dhënave	▪ analizë statistikore sipas parametrave të kërkuara	500
Analiza logjike e të dhënave	▪ Analiza logjike e të dhënave ▪ Analiza kohore e të dhënave ▪ Analiza relative e të dhënave	500
Hartimi i raportit	▪ Shkrimi i raportit ▪ Lëktori ▪ Përpunimi i tekstit ▪ Shtypja e raportit	500 100 500 100
Prezantimi i raportit	▪ tryezë të rrumbullakët me temë për korrupsionin në arsim (rreth 50 pjesëmarrës) ▪ Organizimi dhe administrimi i projektit	300 400
	Gjithsej	7500

Punimi seminarik (ang. *term paper*) paraqet punë individuale të studentit, gjatë së cilës, nën udhëheqjen e mentorit përpunohet tema e dhënë ose e zgjedhur nga vetë studenti. Tema mund të jetë teorike ose praktike. Qëllimi primar i hartimit të punimit seminarik është që të vërtetohet aftësia e studentit për zgjidhjen e pavarur të problemeve praktike ose teorike të cilat domosdo nuk kanë nevojë të kenë karakter origjinal. D.m.th. punimi nuk duhet të paraqes arritje origjinale shkencore, por, vetëm është e nevojshme që të tregohet aftësi të aplikimit të një teorie të caktuar, aparatit analitik ose leximit analitik të tekstit. Punimet mund të sjellin edhe pasqyrë të teorive dhe doktrinae shkencore. Me këtë rast, duhet theksuar që është shumë e rëndësishme që nga ana e studentëve të mbizotërohen rregullat e shkrimit akademik dhe të shtjellimit të problematikës, bashkë me citimin e burimeve. Gjatë të shkruarit të punimit seminarik studenti duhet të ketë parasysh inkorporimin e dijes së tij praktike dhe teorike lidhur me temën konkrete si dhe dhënien e përfundimeve dhe rekomandimeve individuale për zgjidhjen e çështjes që e hulumton.

Punimi seminarik duhet të bazohet në leximin paraprak të temave nga burime të ndryshme (më së paku pesë 5 burime). Shfrytëzimi i literaturës nacionale dhe literaturës së huaj, luan një rol të rëndësishëm gjatë citimeve të profesorëve, autorëve si dhe shkencëtarëve të vendeve të ndryshme, gjë që tregon aftësinë e studentit për një kërkim më të thellë rreth çështjes dhe problematikës që e analizon. PO ashtu, është i mundshëm dhe i lejuar shfrytëzimi i burimeve shkencore nga resurset e internetit, por, duke i respektuar rregullat etike për citim dhe përshkrim të saktë të burimit. Respektimi i rregullave për të shkruar një punim, leximi i literaturave të ndryshme lidhur me temën e zgjedhur si dhe shfrytëzimi i metodologjisë për shkrimin e një punimi, do të ndikoj që ne studentët të përfitojmë një përvojë për shkrimin e punimeve kërkimore dhe shkencore, të kemi një qëndrim kritik dhe një analizë deri diku të bazuar, si dhe gjatë leximit të literaturës do të jemi të ndihmuar që të pasurohemi me të dhëna më të thukëta për problematikën që hulumtohet. Pra, edhe pse, qëllimi i një punimi seminarik është që studenti të ketë:

- Aftësi individuale të shfrytëzimit të literaturës,
- Pjekuri në përpunimin serioz të temës, d.m.th aftësi në zgjedhjen e problemit nga sfera të ndryshme që janë objekt kërkimi (hulumtimi), në veçanti kujdes të posaçëm duhet treguar në respektimin e formës së punimit.

Punimi seminarik (varësisht prej kriterëve të profesorit të lëndës) mund të punohet nga një studentë ose nga një grup studentësh (maksimum deri 3 studentë). Qëllimi i hartimit të punimit seminarik në grup mundëson të mësuarit e studentëve për punë në grup dhe diskutime më të thelluara në mes studentëve anëtarë të grupit. Në këtë mënyrë gjenerohen rezultate më të theksuara, përfundime dhe konkluzione më koncize.

1. Zgjedhja e temës për punim seminarik

Gjatë zgjedhjes së temës është e rëndësishme që nga ana e studentit të zgjidhet materie e cila është në përputhje me interesat dhe njohuritë e tij. Sigurisht që do të zgjasë më gjatë në qoftë se zgjidhet një përmbajtje për të cilën nuk ka shumë njohuri, sepse, me atë rast, duhet të fillohet të studiohet vetë baza e asaj lëmie ose problematike. Por, kjo assesi nuk duhet të jetë pengesë për të studiuar atë çështje dhe në fund të fundit krijimin e punimit. Është gjithashtu e këshillueshme që të zgjidhet një temë për të cilën studenti shfaq interes të madh dhe që do t'i ofroj kënaqësi të plotë. Ky është kushti më i rëndësishëm që të ketë vullnet dhe të jetë i gatshëm të ndajë kohë për të shkruar një punim cilësor. Për arsye se të pasurit kohë është një nga komponentët kryesor. Shpesh vetë profesorët e lëndëve përcaktojnë dhe ndajnë tituj të punimeve të seminarit, por, ndonjëherë ka mundësi që studenti të kërkoj nga profesori një temë për të cilën ka interes të caktuar. Prandaj, zgjedhja e temës është ndoshta parakushti më i rëndësishëm për të shkruar një punim seminarik të mirë, për shkak se nga niveli i interesit varet edhe sasia e mundit dhe përpjekjes që do të jepet nga studenti për hartimin e punimit seminarik.

2. Aktivitetet përgatitore

Edhe pse zakonisht mendohet që koha e nevojshme për hartimin e punimit seminarik është e shkurtër, përsëri, kjo detyrë e studentit kërkon planifikim të realizimit të gjitha aktiviteteve që do të rezultojnë me hartimin e punimit seminarik. Aktivitetet përgatitore kryesisht janë të lidhura me *leximin e literaturës dhe marrjen e shënimeve*.

2.1 . Leximi i literaturës:

Prej njohurive të mëparshme të studentit do të varet se sa literaturë duhet të konsultoj me qëllim që të jetë në gjendje të filloj me punimin. Sigurisht, në qoftë është i njohur mirë me temën e tij, do të ishte mirë që fillimisht vetëm të përsëris bazën dhe me këtë të ndërtoj njohuri të reja. Megjithatë, në qoftë se studenti ka përzgjedh temë për të cilën nuk dinë shumë, është e dëshirueshme që të kërkoj këshilla prej mentorit apo ndonjë të punësuar në bibliotekë, që t'i rekomandojnë artikuj apo libra që do t'i shërbejnë si hyrje në këtë problematikë. Bashkërisht me pyetjen se “**çfarë**” duhet lexuar, në këtë rast, është po aq e rëndësishme edhe pyetja “**si**” duhet lexuar. Sot në burime të shumta teorike janë të theksuara shumë rregulla të përgjithshme për mënyrën e leximit të literaturës akademike, dhe ato mund të përmbledhen si në vijim:

Rregulla 1: Të investohet kohë për lexim. Çdo përmbajtje së pari duhet të shqyrtohet mirë. Studim i mirë do të thotë të investohet kohë që të zotërohet përmbajtja e temës. Nuk është e mundur që për kohë të shkurtër të lexohen disa libra ose artikuj dhe të kemi pasqyrë të qartë për të gjitha pikat e rëndësishme të temës. Prandaj, rregulli i parë dhe kryesor është që të investohet kohë për të arritur një kuptim më të mirë dhe në mënyrë më cilësore të shërbehemi me të gjitha

informacionet e fituara. Natyrisht, kuptohet që të gjithë studentët kanë numër të madh të angazhimeve në universitet, angazhime të cilat reduktojnë mundësinë e leximit të literaturës, por me përqendrim dhe organizim të mirë mund të zvogëlohet koha e nevojshme për tu njohur me çështjet e një teme të veçantë.

Rregulla 2: Të jesh i hapur ndaj tekstit. Me fjalë tjera, gjatë leximit të literaturës së nevojshme, studenti duhet të jetë neutral (i paanshëm) ndaj tekstit që e lexon. Kjo për arsye se gjatë leximit intensiv të literaturës haset në më shumë autorë që mbrojnë pozicione të ndryshme, kështu që lexuesit shpesh do të ndeshen me mendime, argumente dhe përfundime të ndryshme. Është e mirë që nga ana e studentit të mbahet një pozicion neutral, të paktën deri në kohën kur ai me të vërtetë do të jetë i njohur me çështjet që i ka në fokus ose deri sa të bëhet i aftë që të shpreh mendimin ose konkluzionin e tij për një temë të caktuar. Qëndrimi neutral, gjithashtu nënkupton edhe rregullën themelore në vijim:

Rregulla 3: Lexim aktiv dhe kritik. Qasja aktive do të thotë që studenti duhet të jetë në gjendje të njoh vlefshmërinë, besueshmërinë dhe vërtetësinë e argumenteve të parashtruara në tekst. Leximi aktiv gjithashtu supozon edhe kushte përkatëse, për shkak se nuk është e njëjtë të lexohet një tekst në tramvaj apo në tavolinë, për arsye të fitimit të përqendrimit dhe kushteve përkatëse për të shkruar shënime të nevojshme duhet qetësi dhe atmosferë pune për rreth lexuesit (studentit). Po ashtu, është e dëshirueshme që gjithmonë me një dozë mosbesimi t'i qaset tekstit (edhe në qoftë se autori është autoritet i madh në atë fushë). Kritika e tillë do ta drejtojë që vetë të vijë deri te argumentet dhe konkluzionet e tija, që realisht është edhe qëllimi i vërtetë i çdo teksti akademik.

2.3. Marrja e shënimeve

Është shumë e rëndësishme që studenti pas shqyrtimit të literaturës të jetë në gjendje që të mbajë mend dhe të riprodhojë atë që e ka lexuar. Metoda më e mirë dhe më efektive është të mbajturit e shënimeve. Një nga mënyrat më të preferuara është që të merret një fletë letre me format A4, pastaj fleta të ndahet me një linjë vertikale në atë mënyrë që në anën e majtë të ngel 2/3 e fletës ndërsa në anën e djathtë pjesa tjetër. Në anën e majtë do të regjistrojmë argumentet më të rëndësishme dhe gjithë atë që ne mendojmë se duhet të regjistrohet, ndërsa në anën e djathtë (ana më e vogël) do të shërbej për t'i regjistruar vërejtjet, mendimet, shqetësimet, pyetje, shtesa... Me fjalë të tjera, çdo gjë që e nënkuptohet si lexim aktiv dhe kritik. Me këtë rast, për qartësi të shënimeve, çdo artikull apo kapitull libri duhet të regjistrohet në një fletë të re. Rezultati përfundimtar do të jetë shënime të qarta dhe me cilësi dhe vërtetë brenda tekstit të lexuar.

3. Shkrimi i punimit

Shkrimi i punimit përbëhet prej pjesëve të ashtuquajtura: projektimi i punimit dhe strukturimi i tij.

3.1. Projektimi i punimit

Me projektimin e punimit nënkuptohet faza e zhvillimit të përmbajtjes së punimit. Përmbajtja fillon të formulohet që në momentin e zgjedhjes së temës. Gjatë kohës së leximit të literaturës ngadalë fillohet edhe të hartohet koncepti i punimit. Prandaj, pikërisht në këto momente është e këshillueshme që të hartohet edhe **plani i punës**. Ky plan paraqet skeletin e punës, që përbëhet nga përmbajtja e përgjithshme e punimit dhe është ndarë në disa tërësi logjike. Skeleti ka të bëjë vetëm me pjesën qendrore të tekstit. Funkzioni më i rëndësishëm i këtij plani është që të lehtësoj fillimin e shkrimit të punimit të plotë. Nga kjo kuptojmë që punimi do të ndërtohet mbi shënime të planit të punës. Çdo shënim duhet të jetë i përgjithshëm në mënyrë që ai vetëm të zgjerohet dhe në këtë mënyrë të fitojmë punimin e plotë. Prandaj shkrimi i një plani pune është i nevojshëm për shkak se i njëjti shërben:

a) si udhërrëfyes për atë se si duhet të duket punimi,

b) si bazë për të filluar shkrimin e punimit.

Sa më shumë që është lexuar dhe përpunuar literaturë aq më shumë informacione janë pranuar, më shumë konkluzione janë bërë dhe më shumë ide janë krijuar. Për të ruajtur idetë dhe konkluzionet para vetë konceptimit dhe krijimit të planit të punës, rekomandohet e a.q. metoda Brainstorming (*Stuhi idesh*). E cila nënkupton që për të gjitha idetë, gjetjet dhe mendimet të mbahen shënime të shkruara. Me pak fjalë, të gjithë ajo që në atë moment vinë në mendje, pa marrë parasysh se është e palogjikshme si ide për momentin, e pavlefshme ose e rreme, duhet të vihet në letër. Pasi të kemi përfunduar me brainstorming-un, është e nevojshme që gjithçka që është shkruar të filtrohet dhe të mbahen vetëm idetë më të pjekura dhe më të mirë. Këto ide duhet të radhiten në planin e shpjeguar më lartë (planin e punës).

3.2 . Strukturimi i punimit

Pas dizajnit të përmbajtjes, respektivisht projektimit (konceptimit) vijon strukturimi i punimit –fazë që paraqet konceptimin e formës. Kur konceptojmë përmbajtjen, atë duhet ta paraqesim në formë të cilën e ndjekin shumica e teksteve akademike, e cila është si në vijim:

- Hyrje
- Pjesë qendrore (analizë, argumentim)
- Ankesat
- Përfundim

Hyrja, paraqet pjesën e parë në cilën shpjegohen lënda, objektivat dhe metodat e punës. Hyrja nuk duhet të jetë e gjatë, por sa më e shkurtë dhe më përmbledhëse. Hyrja duhet, siç edhe vetë fjala thotë të “hyje” në përmbajtjen e punimit. Prandaj, hyrja domosdoshmërisht (në mënyrë eksplicite) duhet të formuloj tezën kryesore, dhe gjithashtu mund të shtohet dhe sfondi

(prapaskena) e tij: kuptimi i tezës dhe pse është e rëndësishme teza, implikimet e saj, kush e ka përfaqësuar deri tani këtë tezë, kush e ka përfaqësuar tezën kundërtë. Është e dëshirueshme që të shpjegohen metodat e punës, respektivisht, me çfarë jemi shërbyer gjatë hulumtimit (të dhëna statistikore ose anketa), ose thjesht të shpjegojmë se çfarë mjeteve të mendimit kemi zgjedhur që të na çojë deri te në rezultatet (njohuritë) përfundimtare, si p.sh. metoda induktive - përmes shembujve (rasteve) të caktuara vijmë në konkluzionin e përgjithshëm (gjetjet).

Për shkak të shkurtësisë së hyrjes, ekzistojnë disa gjëra që duhet shmangur kur dizajnohet hyrja: Këto janë kryesisht klishe të që nuk kontribuojnë në përshtypjen se puna është e natyrës shkencore, pastaj, fjalët dhe frazat që nuk kontribuojnë në prezantimin e tezës kryesore dhe sfondin e saj, të cilat gjithashtu mund të jenë klishe, përgjithësim të panevojshme, si disa informacione enciklopedike, gjithashtu, nuk ka nevojë edhe për fusnota në hyrje.

Pjesa qendrore e punimit, është pjesa më e gjatë dhe më e rëndësishme e gjithë punimit. Atë e përbën përpunimi (elaborimi, shtjellimi) i çështjes (problematikës) në të cilën “është hy” në pjesën fillestare, d.m.th. në Hyrje. Është veçanërisht e rëndësishme që të paraqiten qëndrimet e sakta të autorit për këtë çështje. Për më tepër, argumentimi si kontribut personal duhet zakonisht të vijojë pasi që janë analizuar tërësisht tezat e autorëve të tjerë. Një argument, apo sipas fjalorit të logjikës një përfundim (konkluzion) përbëhet nga premiset e tij. Premiset janë deklarata logjike që mbështesin ose provojnë argumentin. Premiset mund të jenë:

- a) Logjike: për shembull një përkufizim (definicion), implikim (shpesh përdoret në shkencat humane, të tilla si etnologji, filozofi apo teorinë e letërsisë)
- b) empirike: premiset e tilla zakonisht gjenden në punimet e shkencave shoqërore, siç janë drejtësia, ekonomia etj. Ato përfshijnë shembuj të llojllojshëm, citate, të dhëna statistikore...

Premiset duhet të jenë të kuptueshme, respektivisht të shprehura qartë, të definuara dhe vetëm me një kuptim. Qartësia e premisave i lehtëson lexuesit që në mënyrë më të mirë dhe më të shpejtë të informohet në lidhje me idetë e autorit. Dihet se gjithmonë preferohen tekstet e qarta, të cilat lehtë mund të thithim të gjithë argumentin e autorit. Sigurisht që premiset duhet të jenë të bazuara, gjegjësisht, të mbështetura në logjikë ose në mënyrë empirike. Për shembull, në qoftë se theksohet një e dhënë statistikore, duhet të paraqitet edhe mbështetja (vërtetimi) e tyre, zakonisht nëpërmjet një reference - në qoftë se paraqesim të dhëna për numrin e shkurorëzimeve në vitin 2012, burim (mbështetje) mund të jetë referimi në Byronë Qendrore të Statistikave apo librin e të drejtës familjare.

Pas premisave të cilat duhet të jenë të lidhura logjikisht vijon argumenti. Ai duhet gjithashtu të jetë i paraqitur në mënyrë të qartë dhe i lidhur qartë me tezën kryesore. Nuk ekziston numër i caktuar i argumenteve deri te të cilat duhet të arrihet. Kjo varet nga teza kryesore. Ndonjëherë një argument i qëndrueshëm, i besueshëm dhe i fortë është i mjaftueshëm që të mbrohet teza kryesore, por e gjitha varet nga titulli i punimit dhe teza e vendosur.

Kufizimet nganjëherë janë pjesë integrale e pjesës qendrore, megjithatë, mund të jenë të ndara si pjesë e veçantë e strukturës së punimit. Në këtë pjesë paraqiten vështirësitë potenciale apo aktuale për tezën kryesore, argumentet apo premisat. Kufizimet e tilla duhet të jenë të plota dhe objektive. Shpesh, sidomos në nivel të studimeve deri diplomike, studentët për shkak të mungesës së përvojës dhe kohës u janë të nënshtruar kufizimeve dhe vështirësive. Te ato gjithmonë duhet kthyer dhe në qoftë se vështirësitë janë me të vërtetë të mëdha, dhe për këtë arsye vjen në pyetje besueshmëria dhe korrektësia e punimit, atëherë duhet patjetër të konsultohet mentori i cili mund të kthej studentin në rrugën e duhur, d.m.th. të ja tregoj gjërat e pa logjikshme (mospërputhjet). Këshillat e mentorit janë me siguri ndihma më e madhe në situata të tilla. Në përgjithësi, ankesat e referuara nga mentori, profesorët, kolegët studentë dhe të tjerët duhet gjithmonë të merren në konsideratë. Kundërshtimeve të tilla duhet përgjigjur, respektivisht, të jepen përpjekje që të tregohet që kundërshtimi nuk qëndron ose duhet të rregullohen pjesët e paqarta të punimit. Nëse kundërshtimet me të vërtetë qëndrojnë (mbajnë), atëherë, ose duhet të provohet se ata vetëm relativizojnë tezën, por jo aq shumë sa që të duhet të braktiset, ose duhet të tregohet se cila është mënyra e nevojshme që të modifikohet teza që ajo të jetë immune ndaj kritikave.

Përfundimi, është pjesa e fundit e çdo punimi, i ngjashëm me pjesën fillestare, hyrjen. Përfundimi përsëri duhet të përmbajë formulimin e tezës kryesore. Është e dëshirueshme që po ashtu të theksohet rëndësia e tezës kryesore, të përmbajë përmbledhjen e punimit, bile, edhe të theksoj pyetjet e lëna të hapura. Qëllimi i përfundimit është që të përmbledh atë që është trajtuar dhe deri te e cila është arritur si përfundim, duke i dhënë komentet e fundit. Në përfundim, nuk është e dëshirueshme që të paraqiten argumente të reja, për shkak se vetëm do të nxisë mosbesim dhe paqartësi te i gjithë punimi seminarik.

4. Rekomandime se cilave elemente duhet kushtuar vëmendje të veçantë:

Që puna e hartimit të punimit seminarik të jetë akademike dhe me cilësi të lartë, e plotë, e besueshme, profesionale/shkencore, etj. është e nevojshme që gjatë hartimit të punimit tu kushtohet vëmendje pesë karakteristikave në vijim: qartësisë, saktësisë, shkurtësisë, logjikës dhe strukturimit.

- **Qartësia:** është virtyti themelor i çdo aktiviteti të shkruar, veçanërisht e shkrimit akademik, sepse pa të mbetemi pa funksionin bazë të çdo punimi - *përshkrim i rrugës që çon në njohuri të reja apo hedhjen dritë mbi një temë të re*. Parashtrohet pyetja është se si të arrihet qartësia: kushti themelor është përdorimi i gjuhës standarde/gjuhës letrare, është e dëshirueshme që të shmanget terminologjia tepër profesionale (Natyrisht, kjo nuk do të thotë se terminologjia profesionale nuk duhet të përdoret, por e kundërta, jo në vendet ku do të ishte e panevojshme dhe ku krijon dyshime tek lexuesit për përmbajtjen e punimit), për shkak të qartësisë, është e këshillueshme që

shpesh të jepen shembuj, të cilët në mënyrë figurative pasqyrojnë argumentet, përfundimet dhe shërbejnë si mbështetje, gjegjësisht, e lehtësojnë leximin e tekstit, në fund të fundit, shpesh stili i të shkruarit përcakton edhe shkallën e qartësisë së një teksti, kështu që qartësia nënkupton stil të qëndrueshëm të të shkruarit.

- **Saktësia:** është gjithashtu një tipar jashtëzakonisht i rëndësishëm i cili shumë bazohet në këtë të fundit. Prandaj, saktësia, në fakt është një aspekt i veçantë i qartësisë së tekstit. Me fjalë të tjera, me saktësi nënkuptojmë mënyrën se si përdoret një fjalë e zgjedhur ose term (nacion) në tekst. Të jesh i saktë, nënkupton shmangien e shumë kuptimeve të përkufizimeve (definicioneve), pastaj, t'i kushtohet vëmendje përdorimit të përemrave, dhe në fund të fundit të qenit gjithmonë në përputhje (konsistent) në formulim.

- **Shkurtësia:** Element që lindën nga dy të mëparshmit sigurisht që është shkurtësia ose ngjeshja (konciz). Me këtë nënkuptojmë aftësinë që mendimi apo informacioni të përcillet në formë sa më të shkurtër të jetë e mundur ose në mënyrën sa më ekonomike në formën e saj të plotë. Arsytet për këtë janë që të arrihet qartësi, saktësi dhe lehtësim për lexuesin gjatë “rrugëtimit” në tekstin tonë. Ngjeshja (koncize) mund të arrihet duke shmangur fjalitë e panevojshme të gjata, ose heqjen e fjalëve të panevojshme, d.m.th. fjalët që nuk kontribuojnë në paraqitjen e mendimeve ose informacioneve.

- **Logjika:** paraqet lidhshmërinë e menduar të nocioneve në fjali, ndërmjet fjalive dhe paragrafëve. Për realizimin e logjikës, mendimet duhet të shfaqen një nga një ose si një tërësi e mendimeve pas një tjetër tërësie. Për të arritur këtë, duhet të shfrytëzojmë të a. q. fjalë udhëzuese, siç janë: në fillim (fillimisht), pastaj (më pas), në fund ...

- **Strukturimi i tekstit:** paraqet element jashtëzakonisht të rëndësishëm i cili tashmë është përshkruar në detaje. Me strukturim nënkuptojmë lidhjen e njësive më të mëdha brenda punimit. Kjo arrihet me ndarjen e punimit në paragrafë. Pas kësaj ndarjeje, të gjithë paragrafët i ndajmë në tërësi me nënkapituj (propozohen shenja të titujve dhe nëntitujve, si 1,2,3 ... a , b , c ...). Për të qenë sa më të qartë është e dëshirueshme që të theksojmë atë që do të bëjmë në një tërësi të caktuar dhe të vendosim fjalët udhëzuese.

5. Gabimet në argumentim:

Çdo punë akademike duhet gjithmonë të lexohet – të korrigjohet, ndonjëherë edhe është e shqyrtuar (recenzuar) nga persona përkatës. Deklarata e këtillë supozon ekzistimin e personit (profesor, mentor) i cili do të lexoj punimin. Ai person i zgjedhur ose i caktuar gjithmonë është mjaft të arsimuar dhe i përgatitur për tematikën e punimit dhe që është në gjendje të analizoj në mënyrë kritike punimin. Leximi i tillë kritik është i ndjeshëm ndaj gabimeve në argumentim. Çdo lexues i informuar do të jetë në gjendje të identifikojë jo logjikën dhe gabimet në

argumentim, e cila do të krijojë përshtypjen e paaftësisë (jo profesionalizmit) të autorit dhe mungesën e seriozitetit të punimit.

Ekzistojnë disa lloje themelore të gabimeve në të cilat duhet të kushtojmë vëmendje dhe me siguri që t'i eliminojmë:

- a. Shpesh pretendimin e dikujt që ne duam ta kontestojmë apo kundërshtojmë me qëllim e paraqesim në mënyrë jo të drejtë me qëllim që të rrënohet lehtë. Kjo zakonisht ndodhën kur atë deklaratë e thjeshtojmë ose e ndërlikojmë (komplikojmë). Mentori, recensuesi apo lexuesi i cili ka njohuri për lëndën shumë lehtë do të njohë një gabim të tillë.
- b. Pastaj, me të a.q. *Argumentum ad hominem* është një gabim që ndodh kur një deklaratë sulmohet me diskreditimin e atij që e ka shpalosur atë. Për shembull, sulmojmë autorin për shkak të jetës së tij private, duke mos u përqendruar në vlefshmërinë dhe vërtetësinë e pretendimeve të tij.
- c. Gabimet në referimin e burimeve ndodhin kur një pretendim specifik hidhet poshtë duke sulmuar ose diskredituar grupin, organizatën, ideologjinë që ajo deklaratë ka shpalosur. Për shembull, zvogëlojmë saktësinë dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve që kanë qenë të paraqitura nga marksistët sepse ideologjia marksiste e interpretuar ashpër ka ndikuar në krijimin e një nga format më të rënda të totalitarizmit.
- d. Dykuptimësia (shumë kuptime) është një nga gabimet më të zakonshme në punimet akademike, veçanërisht në ato që autorët e të cilëve janë studentë me pak përvojë. Në dy pohime të lidhura, një fjalë apo frazë përdoret në dy kuptime të ndryshme. Ndonjëherë është e mirë që të shqyrtohet fjalori ose në ndonjë mënyrë tjetër të kontrollohet dhe krahasohet kuptimi i disa frazave ose nocioneve nga autorë të ndryshëm.

6. Referimi dhe citimi:

Qëllimi kryesor i referimit është që të tregohet që ideja apo argumenti i caktuar nuk është shpikur nga vetë autori i punimit. Gjithashtu, qëllimi i referimit është që të informohen lexuesit për burimin e ideve apo argumenteve. Ekzistojnë tre mënyra për referim: citimi, parafrazimi dhe paraqitja.

6.1 . Citimi

Citimi nënkupton paraqitjen e saktë të formulimit origjinal të autorëve të tjerë në punim. Ka tre mënyra për të cituar:

- a) citim i pesë ose më shumë rreshtave,
- b) citim i 3 deri në 5 reshta, dhe
- c) citim deri në 3 reshta.

Ekzistojnë rregulla të caktuara në lidhje me citimin:

- Nëse në punim nga burimi i cituar lëshojmë një pjesë, ajo duhet të tregohet me (...)
- Në qoftë se për qëllim të citimit ndryshojmë shkronjën e parë të madhe në të vogël, apo anasjelltas, këtë e paraqesim me kllapa të mesme,
- Nëse teksti i cituar është vendosur në thonjëza, dhe ai vetë i përmban ato, atëherë, thonjëzat në citat i ndryshojmë në apostrofa të një anshme - ‘’.

6.2 . Parafrazimi:

Parafrazimi paraqet shprehjen e ideve dhe argumenteve të autorëve të tjerë në formë të përmbledhur apo të shpjeguar nga vetë autori i punimit seminarik (në këtë rast, studenti). Gjëja më e rëndësishme është që parafrazimi i ideve dhe dokumenteve duhet patjetër të jetë i saktë. Parafrazimi nuk duhet të vendoset në thonjëza. Pas perfrazës zakonisht vijon referenca, por ekziston situatë e veçantë nëse nga e qartë konteksti i cilit autor apo tekst është parafrazuar.

6.3. Paraqitja

Me paraqitje nënkuptojmë shënimin e punimeve që tregojmë se ku mund të gjendet një ide e ose argument i veçantë që është përmendur në punim. Paraqitja duhet të shoqërohet me referencë, dhe në referencë më shpesh përdoret fraza “shih”, “krahaso” ose “kështu”.

6.4 . Stilet e referimit:

Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se titujt e librave zakonisht shkruhen në font italic, ndërsa artikujt ose revistat vendosen në thonjëza. Në fund, për qartësi vjen lista e referencave që përfshin të dhëna të plota bibliografike të librave, artikujve dhe revistave që janë përdorur në punim pa numrat e faqeve. Dallimi në mes të emrit “bibliografi dhe “literaturë” është fakti se në bibliografi janë përfshirë edhe libra që nuk janë përmendur në referenca, ndërsa në “literaturë” radhiten vetëm ato libra, artikuj dhe revista që janë theksuar si referencë.

Shënimet e burimeve sipas praktikës së deritanishme shënohen në dy mënyra:

“**fusnotë**” – në margjinën e fundit të faqes; shënohet me numra rendorë prej 1 e tutje.

“**endnotë**” – në faqen e fundit; shënohet me numrin rendor 1 e tutje.

Se si do të shënohen dhe cila teknikë do të përdoret, kjo varet nga kandidati. Nëse kandidati është përcaktuar për mënyrën b), ai është i detyruar që faqen ta shënojë me këtë titull “**REGJISTRI I BURIMEVE**”. Kjo faqe vendoset para shtojcës (nëse nuk e ka këtë, atëherë shënohet para faqes së literaturës), por lexuesin duhet ta njoftoni me përmbajtjen e punimit.

“Fusnotat” dhe “endnotat” shfrytëzohen për të dokumentuar:

- për çdo citim të drejtpërdrejtë (në shenjën e thonjzave, “.....”) në tekst;
- për të dhënë çdo fakt që nuk është i njohur shumë, kur autori i atyre fakteve është një person i caktuar.

Në rastin e parë mund të jetë një tekst më i gjatë dhe të “parafrazohet” me fjalët tuaja, por është e domosdoshme të shënohet burimi nga janë marrë të dhënat.

Nëse punimi shtypet në kompjuter, puna është më e lehtë, sepse ka komandë të caktuar për “fusnotat” dhe “endnotat”. P.sh. (CTR+ALT+F).

“Fusnotat” dhe “endnotat” shënohen si shënimi i literaturës, por në fund duhet ta shënoni edhe numrin e faqeve ku gjendet citati në literaturën e dhënë. Për shembull:

1. Mishkin, Walter: Economics, McGraw-Hill, New York, 1977, fq. 24.

Nëse në punim njëherë e keni cituar një vepër të autorit të njëjtë dhe dëshironi ta citoni përsëri, tani nuk duhet t’i jepni përsëri të gjitha të dhënat për autorin, por shënojeni vetëm mbiemrin-emrin dhe shkruani op. cit., fq. Për shembull:

3. Mishkin, Walter: op. cit., fq. 55.

Nëse shfrytëzohet citati nga një vepër që është cituar më parë në “fusnotë” ose “endnotë” në faqen e njëjtë të tekstit, para fusnotës duhet të shkruani “ibid” dhe faqen nga është marrë citati. Për shembull:

4. Ibid., fq. 83.

Nëse shfrytëzohet ndonjë artikull ose ndonjë e dhënë nga interneti (duhet të shkruhet viti kur është shkruar artikulli, e jo viti kur është lexuar ose është paraqitur në internet, apo kur është lexuar, edhe pse shumica e metodologëve kërkojnë që të shkruhet edhe paraqitja e artikullit në internet), atëherë duhet ta shënoni në këtë mënyrë: në artikuj së pari shënohet emri i autorit, pastaj titulli i artikullit, adresa e internetit në të cilën gjendet artikulli dhe në fund shkruhet viti kur është botuar artikulli. Për shembull:

1. Brown, B. N.: “Leading-For All Your Followers”. <http://www.worldweb.org/bzdigest/leading.html>, 1996.

Nëse të dhënat që janë shfrytëzuar nuk janë pjesë e artikullit të paraqitur në internet, por gjenden në një faqe të internetit, është e udhës që të shkruhet emri dhe adresa e faqes së internetit që e keni shfrytëzuar në punën tuaj. P.sh.

<http://www.dol.gov/dol/wb/???>

Për më tepër, ekzistojnë rregulla të veçanta që duhet të ndiqen:

- Titulli i librit, përmbledhja e punimeve, emri i revistës gjithmonë shkruhen me shkronja italik,
- Titulli i artikullit në revistë apo artikujve në përmbledhje gjithmonë është në thonjëza,
- Të dhënat bibliografike gjithmonë duhet çdo herë të përmbajnë shënim për vitin e publikimit,
- Librat dhe përmbledhjet gjithmonë duhet të përmbajnë emrin e botimit,
- Te përmbledhjet gjithmonë duhet të specifikohet emri i redaktorit dhe shtoni shenjën - (red.)

7. Pasi të jetë shkruar punimi

Pasi të kalohen të gjitha procedurat për realizimin e punimit seminarik vijon korrigjimi i gabimeve gramatikore dhe fjalive të paqarta, paragrafët ... Korrigjimi i gabimeve gramatikore mund të bëhet me përfshirjen e të a. q. Opsione për kontroll të drejtshkrimit në programet për shkrim (Microsoft word). Por pothuajse gjithmonë ndodh që të përvidhen disa gabime drejtshkrimore ose sintaksore, dhe mënyra më e mirë për të ri – korrigjim të sigurt është që të shtypet një “kopje” e punimit në letër dhe të kontrollohet përsëri, sepse nga përvoja dihet që punimi në letër është gjithmonë më mirë të lexohet se në monitor. Megjithatë, është shumë e vështirë që të gjenden mospërputhjet (jo logjika) dhe paqartësitë në punim, kryesisht për shkak se vetë autori e ka shkruar. Autorit të punimit shumica e pohimeve të shkruara dhe të paraqitura i janë të kuptueshme, por kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se edhe lexuesit të punimit këto pohime (pretendime) do t’i jenë të qarta. Shpesh ndodh që disa pjesë të tekstit janë me të vërtetë e pakuptueshme dhe e palogjikshme, dhe që vetë autori nuk mund ta vërej këtë.

Rekomandimi për të hequr gabime të tilla është që gjithmonë tu jepet kolegëve, miqve apo të afërmeve nga një kopje të punimit që ta lexojnë dhe t’i kushtojnë vëmendje asaj nëse autori është i shprehur qartë dhe në mënyrë logjike. Vlerësim i tillë objektiv për korrektësinë e deklaratave dhe fjalive do të ndihmojë në masë të madhe për të kapërcyer vështirësitë e fundit në hartimin e punimit.

Pas këtyre kontrolleve të fundit, punimi duhet të përfundoj dhe t’i dorëzohet mentorit ose recensuesit, me të cilët nëpër të gjitha fazat e krijimit të punimit ka ekzistuar detyrimi për konsultime dhe të pranohen sugjerimet dhe kritikrat qëllim-mira të mentorit.

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
1. PJESA QENDRORE	3
1.1.NËNPJESA QENDRORE	4
1.2.NËNPJESA QENDRORE	5
1.3.NËNPJESA QENDRORE	6
PËRFUNDIM	8
LITERATURA.....	9
SHTOJCA.....	10



FAKULTETI JURIDIK

PUNIM SEMINARIK

TEMA:

LËNDA:

MENTOR:

STUDENTI:

Prishtinë, 2013

PUNIMET FINALE

Doktrina dhe praktika mësimore aktuale pedagogjike përfshin që në nivelet e arsimit të lartë të zbatohen metoda specifike të mësimdhënies - përgatitja e punimit përfundimtar. Punimet finale si formë e mësimdhënies janë të përfaqësuara edhe në shumicën e programeve të huaja arsimore, kështu që ata të mund të konsiderohen si metodë që në përgjithësi është e pranuar. Në varësi prej natyrës dhe nivelit të programit mësimor pjesë e të cilit ata janë edhe punimet finale parashikojnë përmbajtje dhe kompleksitet të duhur. Ato lëvizin në diapazon prej punimeve të thjeshta shkollore për një temë të dhënë deri te projektet e plota hulumtuese shkencore teorike, me të gjithë faktorët dhe atributet që projektet e këtij lloji i përfshijnë.

Si metodë mësimore punimet finale kanë dy funksione kryesore:

- arsimore, dhe
- verifikuese

Funksioni arsimor i punimit final është jo vetëm segment i fundit i mësimdhënies së organizuar, por, kurora e gjithë angazhimit (mundit). Në atë sistemohen dhe lidhen njohuritë e fituara nga fusha e lëndës në një njësi koherente njohëse. Elementet, e tërësisë së ngushtë dhe të gjerë të njësive mësimore kristalizojnë vendin e tyre dhe marrëdhëniet e ndërsjella. Me punimin final veçanërisht theksohet rëndësia e përmbajtjes së studimit konkret dhe vlera e tij e përdorimit. Me atë sigurohet një vëzhgim dhe kuptim i plotë i përmbajtjes së paraqitur dhe vendi i tij në sistemin e fondit të gjerë hulumtues shkencor.

Funksioni verifikues i punimit final dallohet nga metodat e zakonshme të mësimdhënies dhe paraqet një lloj të veçantë të verifikimit të njohurive të fituara. Ai nuk është vetëm pjesë e mësimit që ka për qëllim marrjen e njohurive të reja, por edhe një lloj testi me të cilin kandidati provon një nivel të caktuar të zotërimit të përmbajtjes së caktuar. Me këtë kandidati tregon njohjen e elementeve të përmbajtjes së kursit, lidhjen e tyre me njëri-tjetrin dhe kapacitetin e vet për përdorim të mëtejshëm të pavarur të asaj dije. Prandaj, tradicionalisht, punimet finale konsiderohen si dëshmi e pjekurisë dhe arritjes së maturimit të kandidatit me të cilën ai arrin formën e fundit e personalitetit aktiv njohës i gatshëm për edukim në nivelin e ardhshëm më të lartë ose ushtrimin e pavarur të një profesioni të caktuar.

Për shkak të rëndësisë së tij të veçantë në mësimdhënie punimet finale konsiderohen një lloj shkalle e zhvillimit psikologjik dhe jetësor, me të cilat janë përcaktuar biografitë profesionale dhe jetësore të shumicës së njerëzve. Kjo vendos detyrimin për të gjithë pjesëmarrësit në krijimin e tyre, përpjekje maksimale që këto prova të aftësisë dhe pjekurisë të jenë sa më mirë të realizuara.

Pavarësisht rëndësisë së jashtëzakonshme reale dhe simbolike punimeve finale shpesh nuk u jepet vendi të cilin duhet ta kenë. Kjo veçanërisht vlen për përgatitjen e kandidatëve për kryerjen e kësaj pune komplekse dhe gjithëpërfshirëse. Kandidatët shpesh nuk kanë udhëzime të mjaftueshme për atë se si ti kryejnë këto detyra, për shkak se konsultimet me mësimdhënësit janë zakonisht sipërfaqësore dhe të përgjithësuara dhe si rregull realizohen në grupe, kështu që nuk përfshijnë specifikat e mundshme të problemeve të veçanta. Literatura përkatëse për këtë lloj pune në kushtet tona zakonisht mungon, kështu që kandidatët zakonisht përdorin përvojën e paraardhësve të tyre. Prandaj, si rregull, paraqitet numër më i madh ose më i vogël kopjeve më pak të suksesshme të punimeve të mëparshme.

Ky kapitull ka për qëllim që kandidatëve që i pret puna e hartimit të punimit final tu ofroj disa këshilla bazë dhe orientimi në këtë detyrë. Këshillat, janë dhënë parimisht dhe nuk mund të jenë të plota për çdo rast konkret, e cila duhet të zgjidhet në kontaktet ndërmjet mësimeve dhe kandidatit.

2. Llojet e punimeve finale

Punimet finale si procedura mësimore dhe të testimit dukshëm ndryshojnë, para se gjithash, për nga qëllimi i tyre, pastaj për nga kompleksiteti, thellësia e përfshirë, vëllimi, kushteve materiale dhe teknike në dispozicion dhe kushteve tjera. Të gjitha ato kritere të klasifikimit të zbatueshme për projektet e kërkimit, siç janë kriteret e qëllimeve, përmbajtjes, fushës shkencore, funksionet, mund të aplikohen edhe te projektet e punimeve finale. Sigurisht, do të ishte pritje e ekzagjeruar që kontributi i punës së pavarur të studentit të jetë i barabartë me punën e një ekipi të projektit hulumtues. Kjo nuk e përjashton mundësinë që edhe te këto veprimtari të hasen rezultate që kanë rëndësi për zhvillimin e disiplinës shkencore të cilës i përket. Rregull është që autorët e shkëlqyer shkencor radhiten në radhët e këtij lloji. Në praktikën tonë mësimore universitare hasen kryesisht katër lloje të punimeve finale të sistematizuara sipas dedikimit. Këto janë:

- punime seminarike,
- punime të diplomës,
- punime të magjistraturës, dhe
- punime të doktoratës.

Cili do lloji i punimit final që të jetë në pyetje, nënkupton dy (ose më shumë) pjesëmarrës aktiv. Dhe ato janë, studenti dhe mësimeve, të cilët në këtë formë të mësimeve kanë rolin e:

- kandidatit, dhe
- mentorit.

Komunikimi ndërmjet kandidatit dhe mentorit është i dyanshëm, ndërsa bashkëpunimi realizohet në mënyrë aktive që nga përzgjedhja e temës, përmes përgatitjes dhe hartimit të punimit deri në mbrojtjen e saj. Kjo marrëdhënie bashkëpunuese sipas intensitetit të tij i tejkalon të gjitha llojet e tjera të bashkëpunimit, kështu që mund të flasim për një bashkë-autorësi të pjesëmarrësve në punimin final. Punimi final i suksesshëm ose jo i suksesshëm nuk është vetëm dëshmi e aftësisë përkatëse e kandidatit, por edhe e angazhimit të mentorit, respektivisht, e shkallës të suksesit të bashkëpunimit të tyre.

2.1. Punimi i diplomës

Punimi i diplomës paraqet një lloj konsiderueshëm më kompleks dhe më të gjerë të punimeve finale, në krahasim me punimin seminarik. Paraqiten si forma të fundit të mësimeve që sistemojnë dhe vërtetojnë kualifikimet e kandidatëve për punë të mëtejshme të pavarur. Kandidati me temën e diplomës duhet të fitojë një pasqyrë të qartë dhe të plotë për rëndësinë dhe nevojat e përmbajtjes së plan programit në të cilin ai ka punuar dhe të bëhet i vetëdijshëm për vlerën e tij të përdorimit. Roli i tij nuk është protokollar, por ajo është një nga format më aktive dhe më reale të kësaj së studentit në proceset arsimore.

Vëllimi, përmbajtja dhe mënyra e hartimit të temës varet nga fusha mësimore-shkencore me të cilat tema është e lidhur. Punimet e mira të këtij lloji realizohen në vëllim prej 40 deri në 50 faqe, në varësi të përmbajtjes, mënyrës të të shkruarit dhe kontributit. Është e qartë se puna në fushën e shkencave shoqërore dhe humanitare, sipas rregullës, është tekstualisht më e pasur se punimet nga fusha e teknikës, informatikës apo matematikës.

Raporti ndaj punimit të diplomës varet nga tradita e institucionit shkencor në të cilën ai do të realizohet. Në disa fakultet, atyre u jepet rëndësi e jashtëzakonshme, nga përzgjedhja, përgatitja e deri në përmbajtjen teknike dhe mbrojtjen, ndërsa, në disa institucione të arsimit të lartë rëndësia e saj është marginalizuar ose është lënë plotësisht mënjanë. Në mënyrë të ngjashme ndikon edhe opinion personal i mentorit dhe anëtarëve të komisionit.

Punimi i diplomës mund të konceptohet si seksione të sistematizuara apo pikëpamje të një teorie ose grupi të teorive, kushtëzimeve të tyre, krahasime, por mund të vendosen edhe si projekte të hulumtimeve të vërteta. Në praktikë, më e zakonshme është “*Vija e mesme*”, kështu që puna fillon me një këndvështrim teorik dhe vazhdon si hulumtim i shkurtuar në dritën e mbrojtjes së hipotezës teorike.

3. Përgatitja e punimeve finale

Ajo që për çdo kandidat i cili përballet me hartimin e punimit seminarik, diplomës, magistraturës apo doktoratës duhet të ketë parasysh, që “çdo rrjedhë është fryt i punës së madhe”. Edhe Buffon, shkencëtari i famshëm francez - natyralist i shekullit 18, në kohën e tij ka thënë: “*Gjenialiteti, është durim*”. Përveç njohurisë, durimi dhe puna e lodhshme janë parakusht për krijimin e punimeve të këtij lloji.

I gabuar është mendimi dhe është një keqkuptim të madh që krijuesit e famshëm dhe njerëzit e mëdhenj lehtë dhe shpejtë krijojnë, përmes “*ideve të zgjuara*” apo intuitës. E gjithë historia njerëzore, historia e shkencës dhe e artit janë dëshmitarë që krijimet e mëdha janë fryt i punës së madhe, zelli të madh, këmbënguljes dhe vetë angazhimit heroik. Një pikturë artistike, me gjithë talentin e autorit të saj, paraqitjen e saj ia ka borxh punës me ngjyra dhe pëlhurë që ka zgjatur me ditë, muaj apo edhe vite.

Realizimi i projektit hulumtues dhe përgatitja e punimit final të çdo lloji, para se gjithash është punë që kërkon durim dhe angazhim. Të gjithë që nisin në këtë rrugë duhet të jenë të përgatitur për mund gjatë një kohe të gjatë. Si edhe çdo rrugë tjetër, edhe kjo rrugë fillon me hapin e parë.

3.1. Përzgjedhja e temës

Hapi i parë në secilin nga këto projekte është përzgjedhja e temës apo lëndës së hulumtimit. Megjithatë, hapi i parë, është rrallë të jetë i rastit apo spontan, sepse ai lë të kuptohet shumë më herët. Këto shenja paraprake duhet të ndiqen dhe të respektohen, për shkak se përzgjedhja e temës është një nga faktorët më vendimtar në punën hulumtuese dhe për hartimin e punimit shkencor.

Pyetja që lind në lidhje me përzgjedhjen e temës: **kur të zgjidhet tema?** Edhe pse përgjigja nuk ka vlefshmëri universale, assesi nuk ka nevojë të prisni momentin e fundit. Te punimi i diplomës dhe i magistraturës ky përcaktim duhet të jetë gjatë semestrit të fundit ose vitit të fundit, ndërsa për punimin e doktoratës më parë. Zgjedhja në kohë kryesisht është e menduar dhe kursen kohë. Në parim, në qoftë se kemi temë të zgjedhur dhe madje, edhe në qoftë se këtë e kemi bërë vetë pa konsultim me mentorin, na mundëson që të mbledhim pak nga pak dhe pa shumë mund

materialet interesante, të dhëna dhe literaturën në lidhje me temën. Kështu që, gradualisht krijohet një dosje e konsiderueshme dhe fitohet në kohë.

Për zgjedhjen e hershme të lëndës së punimit nuk janë pa rëndësi edhe proceset psikologjike. Është e njohur se çdo vendimi të menduar, zbulimi i paraprin një proces kompleks por i padukshëm i të menduarit. Gjatë këtij procesi shpirti ynë afrohet me lëndën e punimit nga shumë anë. Në rrethana të tilla, autori shpesh e njeh punën e tij vetëm kur ajo ka përfunduar.

Nuk duhet neglizhuar edhe arsyet praktike për përzgjedhjen më të hershme. Nëse e kuptojmë se tema e zgjedhur është shumë e vështirë, ose në ndonjë mënyrë tjetër e paarrtshme, mund të zgjedhim një fushë tjetër apo një temë tjetër. Dëm i madh dhe humbje kohe në këtë rast nuk do të ndodhë, por nëse kjo ndodhën para vetë afatit.

Pyetja e dytë që i shqetëson ato që duhet të hartojnë punimin është: **kush duhet ta propozojë temën?** Kjo zgjedhje duhet të dalë nga vetë kandidati, sepse askush nuk është në gjendje që më mirë se ai të ndjej interesat, prirjet dhe aftësitë e tij.

Të gjithë ne kemi interesi dhe udhëzime të caktuara në jetën e përditshme dhe bile edhe në këto rrethana. Që të bëjmë një punë të mirë duhet të jemi shumë të interesuar për atë, nga ana tjetër, ajo punë nuk duhet të kapërcej aftësitë tona. Nëse tema e zgjedhur nuk është në përputhje me këto kushte, në qoftë se është e imponuar, atëherë shanset janë më të ulëta që rezultati të jetë i mirë. Nëse interesimi ynë nuk është i gjallë, ndërsa vështirësitë janë dekurajuese, atëherë punimi do të zgjatet dhe ndoshta do të ndërpritet.

Pyetja të cilës është më vështirë për t'i u përgjigjur është: **cila temë të zgjidhet?** Në parim mund të jetë secila pyetje, çdo temë bile edhe ajo më banale, të cilën shumë njerëz para neve e kanë përpunuar. Çdo detaj, pa marrë parasysh sa duket i zakonshëm dhe i konsumuar mund të ngrihet në nivelin e temës aktuale dhe çështjes hulumtuese interesant nëse mbi atë aplikohen metoda origjinale kërkimore, qasje e re, shqyrtim i ri. Duhet kërkuar risinë edhe te ajo që nuk është e re dhe që çdo herë mund të shqyrtohet në mënyrë të re. Shkenca nuk është vetëm zbulim i fakteve të reja, ato nuk janë zbulime spektakolare që do të revolucionarizojnë jetën e njerëzve, ajo më shpesh është zbulim i mënyrave të reja të fakteve të ndërlidhura. Në fund të fundit, shumë gjëra vlen që të verifikohen në rrethana të reja.

Në atë turmë të pakufizuar të zgjedhjeve të mundshme vlejné edhe disa këshilla të përgjithshme. Një prej tyre është se gjithmonë është më mirë që të merret një **temë më pak e gjerë** se sa të ballafaqohemi me fushë të gjerë. Pyetjet që në pamje të parë duken të kufizuara, munden të marrin në përpunimin dhe analizën e më vonshme një gjerësi dhe rëndësi të jashtëzakonshme.

Në atë rrugë zbulohen rezultate të shumta që e zgjerojnë fushën e kërkimit dhe kalojnë kornizën e ngushtë të tematikës. Tërheqja në kërkim të shumë pyetjeve nuk përqendron vëmendjen në asnjërën nga ata, me çfarë humbet orientimi dhe kuptimi hulumtues. Si gjithmonë në jetë, është më mirë që të merret më pak, më të mirën, më të thelluarën, më seriozen.

Tema duhet që sa më shumë të saktësohet, konkretizohet, të kufizohen lëvizjet anësh dhe të përcaktohet qartë drejtimi i hulumtimit dhe ajo që është në fokus të interesit të tij. Përkufizimi i mirë i lëndës së hulumtimit, në fund të fundit, kërkon një ndarje të qartë të asaj që është lëndë prej asaj që nuk do të hulumtohet. Cilat do që të jenë aspiratat tona, ajo që ne bëjmë është vetëm një kokërr e vogël në det krahasuar me atë që e bën jetën e njeriut dhe natyrën rreth tij. Këtë kokërr duhet ndarë në mënyrë të qartë nga të tjerat.

Punimet teorike në shikim të parë duken më të lehta dhe më tërheqëse, **por diskutimet (hulumtimet) teorike mund tu rekomandohen vetëm kandidatëve më të mirë.** Ata kërkojnë një konfrontim me materie të gjerë apo hulumtim të pacaktuar. Diskutimet teorike nuk janë vetëm theksim i asaj se çfarë dikush veç më ka shkruar, ose përshtkrim i tyre, por, ato kërkojnë një

pikiatë shumë më të thellë dhe lidhje të tërë fushave. Studimet e këtij lloji kërkojnë përveç një objektiviteti të madh, bazë të të dhënave të dokumentuar dhe analizë të kujdesshme të një numri të madh të fakteve, librave, punimeve. Cektësia dhe verbalizmi drejt të cilave shumë kandidatë që janë të angazhuar për hulumtimin teorik anojnë, zakonisht marrin pamjen e karikaturave që asnjërin nuk e kënaqën. Për më tepër, veprat e këtij lloji kanë qëllime të parashikuara dhe ato duhet të depërtojnë në hulumtime të cilat nuk janë të botuara.

Kurthet e zakonshme të hulumtimit teorik si lëndë e punimit janë të lidhur me vështirësitë praktike. Autorët e këtyre tezave të magjistraturës apo disertacione doktrate duhet të jenë të aftë të lexojnë dhe të kuptojnë të paktën dy gjuhë të huaja në mënyrë që të bëjnë një prerje të kënaqshme të literaturës shkencore të botuar. Prandaj, këto vepra edhe pse në dukje të parë tërheqëse dhe të arritshme, janë të mbushura me shumë vështirësi, si me ato epistemologjike ashtu edhe me ato teknike.

Duhet të shmangen temat për të cilat në kohët e fundit janë realizuar studime të rëndësishme, tezat apo punime. Në këto tema zakonisht janë theksuar ajo që tashmë është thënë apo lexuesve sipërfaqësor ose studiuesve ashtu u duket. Të përsëritet tjetri, në fund të fundit, nuk jep kënaqësinë e krijimit që e dëshiron çdo studiues. Këto tema, së bashku me të gjitha përpjekjet origjinale, japin përshtypje të eksploatimit dhe eksplorimit.

Ne duhet të përpiqemi për fushat e reja dhe aktuale që janë në fokus të interesave më të gjera sociale. Tema të tilla ka në çdo disiplinë shkencore dhe janë lëndë e interesit të një rrethi shkencor dhe joshkencor më të gjerë. Tema të tilla janë të “*në trend*” dhe pranohen me entuziazëm edhe kur kontributi i tyre real është i vogël. Në fund të fundit, le të kujtojmë preokupimin tonë të kohëve të fundit me socializmin, ose ekologjinë, menaxhimin.

Duhet të përdoren njohuritë dhe aftësitë specifike. Kjo do të thotë se në kornizën e studimeve bazë dhe fushat themelore duhet të përdoren njohuritë për shkencat e tjera ose interesi për ato. Kjo arsyetohet edhe pse duket zgjedhja e rrugës me rezistencë më të vogël. Me këtë lehtësohet puna përgatitore dhe arrihet një nivel më i lartë performance dhe kontributi social dhe shkencor më i rëndësishëm.

Duhet të përdoret linja e zhvillimit të vetë që do të thotë është e këshillueshme që të përcaktohet për një fushë të veçantë të hulumtimit dhe ajo të zhvillohet me një seri të analizave dhe hulumtimeve më të thelluara dhe më serioze. Nëse në fushë të caktuar është realizuar punim diplome, e filluara duhet të përfundojë me temë magjistrature dhe me përpjekje tjera hulumtuese. Është shumë më e vështirë dhe më pak e dobishme për tu kapur një fushë e re, me konstatimin se qasja e filluar të jetë shterur.

Shqyrtimi i vlerësimeve të mëparshme, sepse pa marrë parasysh se sa ato janë “subjektive” dhe fryti i momentit, përsëri diçka flasin për shijet dhe preferencat. Tema duhet të kërkohet në ato fusha në të cilat ne jemi të fokusuar (departamenti, seksioni, grupi) dhe nga cilët lëndë kemi rezultate (nota) më të larta. Në fund të fundit, disa nga mentorët si kusht për pranimin e kandidatëve u kërkojnë rezultat mesatar të duhur nga lënda e tij ose lëndëve të ngjashme.

Personaliteti i mentorit është shpesh vendimtar për zgjedhjen e një teme apo fushe. Kjo është jeta, thjesht, me dikë mund të bashkëpunohet dhe me disa jo. Neveria thekson një reagim të ngjashëm dhe konfliktet janë të pashmangshme.

Ngurrimi i tepruar nuk është i dëshirueshëm në asnjë vendim, bile, edhe te këto. Të vlerësohet situata dhe pastaj “*hedhja në ujë dhe të notohet*”. Vetëm ata që hidhen në ujë mësojnë të notojnë.

TEMAT E DIPLOMËS

Në këtë material, kur flasim për temat e diplomës, e kemi fjalën për ata që mbështeten në hulumtime. Nuk e kemi trajtuar esenë e zgjeruar më vete, sepse ato janë shumë të ngjashme me temat e diplomës. Në çfarëdo shkrimi, kini parasysh të zbatoni rregullat e institucionit ku studioni. Tema e diplomës është një lloj studimi i thelluar i një teme ose çështjeje nga fushat e shkencave shoqërore. Për studentët mund të jetë problem se çfarë teme të zgjedhin. Megjithatë, nuk do të jeni vetëm - departamenti ose fakulteti do t'ju caktojë një mentor. Rekomandojmë të zgjidhni një temë që është e menaxhueshme dhe që t'ju ngjallë interes gjithë vitin.

Si ta zgjidhni temën e diplomës

Sigurisht që këtu është e pamundur të japim të gjitha temat e mundshme nga shkencat shoqërore që studentët mund t'i zgjedhin si temë diplome; edhe sikur të mundnim, çështjet aktuale apo 'të nxehta' ndryshojnë nga viti në viti. Megjithatë, temat e diplomës mund të ndahen në disa kategori të caktuara, pavarësisht nga fusha e studimit të cilës i përkasin (sociologji, shkenca politike, politika shoqërore, etj.), për shembull:

- Historikë
- Teorikë
- Politikë (në kuptimin e politikave kombëtare/ndërkombëtare, dhe jo të shkencave politike, që do të ishte fusha e studimit)
- Kombëtarë
- Ndërkombëtarë/krahasues/globalë
- Lokalë

Ky klasifikim në të vërtetë është paksa i thjeshtëzuar, sepse një temë diplome mund të përkasë në më shumë se sa një kategori: megjithatë, ne mendojmë se është i dobishëm.

Në këtë fazë mund të flisni edhe me persona të tjerë dhe t'u tregoni atë që po bëni, pse keni interes në këtë projekt - po të jenë edhe ata të interesuar, atëherë ndoshta kini bërë zgjedhje të mirë! Sidoqoftë, nyjëtimi i proceseve të të menduarit në një mënyrë që është e kuptueshme për të tjerët, gjithmonë është me vlerë.

Hartimi i temës së diplomës

Fillimi i një projekti është gjithmonë i vështirë. Faza e parë është të keni një ide, por pastaj duhet të vendosni se cila është mënyra më e mirë për të vazhduar më tej.

Shumica e njerëzve fillojnë duke lexuar për temën dhe kjo shpesh është e dobishme, por në fakt, duhet të keni një lloj ideje orientuese, sepse përndryshe nuk do të mund ta përdorni kohën mirë.

Një mënyrë tjetër për të filluar është me anë të formulimit të pyetjes së hulumtimit. Pasja e një pyetjeje hulumtimi është thelbësore për një temë diplome të suksesshme. Sigurisht, në fillim

pyetja do të jetë pak e përgjithshme, madje edhe e mjegullt. Ndoshta doni të studioni për “numrin e vajzave nga zonat rurale në arsimin e lartë”. Është temë interesante, por duhet të keni mundësinë të bëni një pyetje më specifike dhe më të qartë për të (duke pasur parasysh se tema e diplomës në nivelin e studentit ka gamë të kufizuar se çfarë mund të trajtojë dhe se nuk keni shumë kohë të gjatë për të studiuar gjithçka që ka të bëjë me këtë temë). Pra duhet ta formuloni pyetjen e hulumtimit në mënyrë që:

- të ketë lidhje me atë që doni të zbuloni
- Të jetë e menaxhueshme: pra, të keni qasje tek popullimi i hulumtimit, të keni mundësi të gjeni literaturë, të mos ketë probleme etike të pakapërcyeshme, të keni njohuri të mjaftueshme për metodologjitë e përshtatshme, etj.

Nuk është shumë e vështirë. Po shkruani një temë diplome, e jo një disertacion doktrate! Sado që të mundoheni, nuk do të jeni në gjendje të mbuloni gjithçka nga ajo fushë (për shkak të kufizimeve në numrin e fjalëve) që ka të bëjë me temën (në fakt, edhe pjesa më e madhe e punimeve të doktoratës nuk e arrijnë një gjë të tillë).

Të marrë përgjigje (brenda kohës dhe burimeve që keni). Kini kujdes të mos e nënvlerësoni kohën që do t’ju duhet për ta bërë këtë punë; ju këshillojmë që të krijoni një kalendar (të cilin e hartoni duke shkuar mbrapsht nga data e dorëzimit) dhe bëni ç ‘është e mundur që t’i përmbaheni atij. Mos harroni që do të keni edhe detyra tjera për të bërë gjatë asaj periudhe.

Zgjedhja e metodologjisë/metodave

Zgjedhja e metodologjisë dhe metodave të mbledhjes së të dhënave do të përcaktohet nga natyra e pyetjes së hulumtimit.

Mbikëqyrja

Shumica e departamenteve dhe fakulteteve caktojnë një pedagog udhëheqës për temat e diplomës. Ky zakonisht është një anëtar i personelit mësimdhënës të fakultetit që ka përvojë ose interes në atë fushë. Duhet ta ‘shfrytëzoni’ pedagogun udhëheqës sa të mundni, si burim ekspertize për temën tuaj. Roli i tyre është:

- T’ju këshillojë për mundësinë e kryerjes së hulumtimit dhe t’ju ndihmojë të zgjidhni një metodologji të përshtatshme;
- T’ju drejtojë tek literatura e përshtatshme;
- T’ju këshillojë për modelin e mbledhjes së të dhënave dhe strategjitë e analizës;
- Të diskutojë me ju strukturën dhe paraqitjen e temës së diplomës;
- Të bëjë komente mbi versionet e para të punimit. Mënyra se si do të bëhet kjo varet nga praktika e institucionit: disa shohin vetëm kopjen e parë të përfunduar, të tjerë vetëm disa kapituj; pyesni se si janë rregullat në institucionin tuaj.

Struktura e temës së diplomës

Elementë paraprakë

Faqja e titullit, ku duhet të përfshihen:

- Titulli i temës së diplomës
- Të dhënat e studentit (emri ose numri i identifikimit të studentit; pyesni se cilat janë rregullat në institucionin tuaj)
- Programi i studimeve (aty ku ka të tillë)
- Departamenti/fakulteti/universiteti
- Viti

Abstrakti: që zakonisht është rreth 250 fjalë (por pyesni se cilat janë rregullat për temën e diplomës suaj) dhe duhet të përfshijë:

Informacion për temën

Informacion për çka keni bërë që ta hulumtoni atë

Gjetjet dhe përfundimet kryesore

Falënderimet: (zakonisht janë opcionale): mundësi për të shkruar një deklaratë personale për të falënderuar ata që ju kanë ndihmuar dhe mbështetur, ose ku tregoni se pse vendosët ta bëni këtë hulumtim.

Përmbajtja: kjo duhet të jetë një pasqyrë e detajuar e punimit, ku paraqiten numrat e faqeve. Është praktikë e zakonshme që figurat dhe tabelat, dhe numrat e faqeve që u korrespondojnë atyre, të vihen ndarazi në pasqyrën e punimit.

Trupi i temës së diplomës: mënyra e organizimit të tij do të varet nga lloji i projektit që keni kryer, sidomos llojet e literaturës që keni përdorur, të dhënat që keni mbledhur dhe analizuar. Më poshtë kemi dhënë një listë ‘tipike’ të titujve të krerëve:

Hyrja: Këtu përfshihet informacion për natyrën e temës së diplomës, çështjet që po trajtoni, dhe disa ‘shënjes/tregues’ që i tregojnë lexuesit se çfarë ka në secilin krye.

Metodologjia dhe metodat: një diskutim dhe përshkrim (si dhe përgjigje e zgjedhjes së bërë) i metodologjisë dhe metodave të mbledhjes së të dhënave; detaje të popullimit dhe kampionit (mostrës); një diskutim i strategjisë së analizës që do të përdorni, për të dhënat; një diskutim i çështjeve etike.

Gjetjet: që në thelb janë, çfarë keni bërë gjatë hulumtimit dhe çfarë keni gjetur (rezultatet). Kjo mund të jetë thjesht një paraqitje e të dhënave por mund të përfshijë edhe ndonjë diskutim. Mund të përfshijë diagrame dhe grafikë, ose figura, skedarë audio dhe video.

Diskutimi: Çfarë domethënieje kanë gjetjet.

Përfundimi: Këtu keni mundësinë t'i jepni përgjigje të gjitha pyetjeve të hulumtimit. Po kështu, mund të thoni se si kjo përgjigje mund të përdoret për të bërë propozime të politikave të reja, ose, për të sjellë ndryshime në praktikë, ose për të nxjerre përfundime teorike. Kjo do të varet nga natyra e projektit.

Shtojcat: Përmbledhje materialesh që kanë lidhje me projektin, por në një formë që nuk do të ishte e përshtatshme (zakonisht sepse janë shumë të gjata dhe të hollësishme) për t'i futur në tekstin kryesor të temës së diplomës. Megjithatë, ky nuk është vendi për të futur çdo lloj materiali për të cilin nuk kishte vend në tekstin kryesor. Zakonisht, shtojcat përmbajnë:

- Shembuj pyetësorësh
- Shembuj të formularëve të pranimi
- Tabela të hollësishme të të dhënave (sidomos nëse i keni paraqitur ato në mënyrë grafike diku gjetkë)
- Pjesë nga dokumente politikash
- Një shembull nga të dhënat e mbledhura (për shembull, një intervistë e zbardhur, ose një pyetësor i plotësuar)
- Çdo gjë tjetër që *duhet* përfshirë por që nuk mund të vihet në tekstin kryesor.

Referencat: Një listë e plotë e të gjitha referencave të materialeve që keni cituar si dhe të materialeve të tjera nga keni mund të keni marrë ide, por jo citime të drejtpërdrejta. Institucioni juaj do të ketë rregulla se cilin prej sistemeve të paraqitjes se referencave duhet të përdorni. Studiojeni atë mirë. (Disa institucione bëjnë dallimi midis *referencave* dhe *bibliografisë*, të tjerë, jo. Teknikisht, referencat janë citimet dhe materialet e tjera që i keni cituar në punimin tuaj. Bibliografi mund të konsiderohen të gjitha veprat e tjera që ju kanë ndihmuar dhe informuar, por nga të cilat nuk keni marrë citime).

Referencat

Referencat kanë tre qëllime kryesore:

1. Ato tregojnë se ku i keni marrë idetë dhe citimet, duke treguar kështu se nuk jemi përpjekur të paraqitni idetë dhe punimet e të tjerëve si tuajat.
2. Ato i japin mundësi lexuesit të ndjekin idetë tuaja më tej dhe më në thellësi (nëse dhe të vërtetojnë që keni përdorur materialet e duhura).
3. Ato tregojnë që keni mësuar se si të përdorni punën e të tjerëve për të zhvilluar dhe përgjigjet tuaja.

Referencat. Të gjitha referencat bëjnë të njëjtën gjë: ato japin informacion të hollësishëm se nga vjen materiali ose burimi origjinal. Të gjitha referencat duhet të përfshijnë emrin e autorit, datën e botimit, **titullin** e punimit, vendin e botimit dhe botuesin (ndonjëherë, për shembull, tek periodikët, edhe numrat e faqeve). Ekziston një numër i madh sistemesh për krijimin dhe paraqitjen e referencave: ju duhet të përdorni atë që është miratuar nga institucioni juaj. Megjithatë, një referencë sipas sistemit të Harvardit (i parapëlqyeri ynë) ka këtë pamje:

Deakin, N. Finer-Jones, C. dhe Mathevvs, B. (2004) **Welfare and the State: Critical Concepts in Political Science** (Mirëqenia sociale dhe shteti: koncepte kritike në shkencat politike), London: Routledge.

Vlerësimi

Çdo fakultet ose universitet ka sistemin e vet të vlerësimit të temave të diplomës - ky është një informacion tek i cili duhet të keni qasje. Lexojeni atë *përpara* se të filloni shkrimin e punimit, në mënyrë që të mos ziheni në befasi nga kërkesa të pazakonta. Leximi i udhëzimeve të vlerësimit është gjithashtu një mënyrë e mirë për të parë se çfarë pritet nga ju.

Një paralajmërim i fundit: plagjiatura

Plagjiatura është thjesht përdorimi i punës së një personi tjetër dhe paraqitja e tij sikur është i yni (pra, pa dhënë referenca dhe citime). Ajo është e papranueshme moralisht, por edhe mund t'ju kushtojë rëndë në qoftë se kapeni. (Tani ka edhe programe kompjuterike të sofistikuara që shërbejnë pikërisht për këtë).

Por plagjiatura nuk ka të bëjë vetëm me përdorimin e fjalëve të dikujt tjetër pa e pranuar autorin e ligjshëm të tyre, por përfshin edhe gjërat e paraqitura në listën e mëposhtme (që nuk është shteruese):

- Përdorimi fjalë-për-fjalë i një materiali të botuar më parë;
- Parafrazimi i përafërt i fjalëve të një teksti (zakonisht një libër, periodik, ose shënimet e leksionit);
- Kopjimin dhe përdorimin e teksteve të marra nga interneti;
- Kopjimi i punës së një studenti tjetër;
- Përdorimi i ideve për të cilat keni lexuar, pa thënë se cila është origjina e tyre;
- Përdorimi i një shprehjeje të këndshme e gjetur apo e mësuar diku, por pa thënë ku.
- Përdorimi i grafikëve, figurave, diagrameve, etj., që i keni marrë të gatshme ose shkarkuar nga interneti pa leje ose pa cituar se cili është burimi i materialit.